



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 90

1 gusht

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 406, datë 27.6.2012	Për miratimin e rekomandimeve për luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2012	4977
Vendim i KM nr. 474, datë 25.7.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1400, datë 17.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin e kurseve në SHISH dhe trajtimin e pjesëmarrësve”	4988
Vendim i GJK nr. 39, datë 18.7.2012	Me objekt shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2011-1238 (353), datë 5.7.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.....	4989
Vendim i GJK nr. 40, datë 18.7.2012	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimeve nr. 169, datë 3.12.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr. 00-2010-455, datë 12.2.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë	5000

VENDIM
Nr. 406, datë 27.6.2012

**PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT, PËR
VITIN 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54 pika 1 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rekomandimeve për luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2012, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë t’ia përcjellë menjëherë Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet e miratuara.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REKOMANDIME TË MINISTRIT TË DREJTËSISË
NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
PËR LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2012

I. Hyrje

Ministri i Drejtësisë në emër të Këshillit të Ministrave i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet që duhet të mbahen parasysh për vitin në vazhdim, në luftën kundër kriminalitetit në zbatim të nenit 54/1 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rekomandimet synojnë përmirësimin e efektivitetit të masave për parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit. Ky funksion lidhet me kompetencën ligjore të Ministrisë së Drejtësisë për ndjekjen dhe përgjegjësinë për realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë të parashikuar nga ligji nr. 8678/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar. Rekomandimet janë të orientuara drejt respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe drejt parandalimit të shkeljeve të ligjit, si premisa bazë për zhvillimin demokratik dhe integrimin evropian të Republikës së Shqipërisë. Paraqitja e rekomandimeve nga Ministri i Drejtësisë, në emër të Këshillit të Ministrave, te Prokurori i Përgjithshëm është një mekanizëm ligjor balancues, që materializon ndarjen e pushteteve të sistemit të qeverisjes. Ministria e Drejtësisë, si pjesë e pushtetit ekzekutiv, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me prokurorinë në respekt të plotë me parimin e qeverisjes të sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës “Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”.

Ministria e Drejtësisë, për përgatitjen e këtyre rekomandimeve, është mbështetur në problematikën e konstatuar gjatë inspektimeve të ushtruara pranë organit të Prokurorisë për vitin 2011, në statistikën zyrtare të dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme, në analizën e dokumenteve strategjike qeveritare dhe në raportet e organizmave ndërkombëtarë, që lidhen me çështjet e krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikut të lëndëve narkotike. Gjithashtu, në përgatitjen e këtyre rekomandimeve është shfrytëzuar edhe kontributi i paraqitur nga strukturat e pushtetit ekzekutiv, të cilat kanë në përbërje të tyre personel, që me ligj i është njohur cilësia e Policisë Gjyqësore.

II. Angazhimet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit



Këshilli i Ministrave ka konfirmuar në një set dokumentesh strategjike vullnetin për realizimin e reformave të rëndësishme në fushën e drejtësisë të fokusuara në forcimin e shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Dokumente të tilla janë: SKZHI, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, Strategjia Antikorrupsion, si dhe plani i veprimit për adresimin e 12 prioriteteve kyçe të Komisionit European në funksion të procesit të integritetit european. Planu qeveritar i veprimit të 12 rekomandimeve është dokumenti më i fundit i miratuar dhe mbledh në një akt të vetëm prioritetet dhe masat e veprimit. Prioritetet strategjike të shpallura në këtë plan për sistemin e drejtësisë janë:

1. Forcimi i shtetit të së drejtës për të garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e institucioneve gjyqësore (rekomandimi nr. 7);

2. Forcimi i luftës kundër korrupsionit lidhur me ndjekjen dhe dënimin e çështjeve të korrupsionit në të gjitha nivelet (rekomandimi nr. 8);

3. Forcimi i luftës kundër krimit të organizuar duke rritur bashkëpunimin me partnerët rajonalë dhe koordinimin e agjencive të zbatimit të ligjit në këtë fushë (rekomandimi nr. 9);

4. Përmirësimi i trajtimit të të drejtave të të ndaluarve në rajonet e policisë, në qendrat e paraburgimit dhe në burgje, si dhe të forcohet ndjekja gjyqësore e çështjeve për keqtrajtim, si dhe të përmirësohet zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit në këtë drejtim (rekomandimi nr. 12).

1. Forcimi i shtetit të së drejtës

Gjatë viteve të fundit Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë reforma të rëndësishme në fushën e drejtësisë, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së drejtësisë, hartimin e legjislacionit në përputhje me standardet europiane dhe monitorimin e zbatimit të suksesshëm të tij. Tashmë, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 20.7.2011 është miratuar Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe plani i saj i veprimit, e cila është në fazën e zbatimit të saj.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë përcakton këtë vizion për sistemin e drejtësisë “Shqipëria do të gëzojë statusin e një vendi të integruar në strukturat europiane dhe euroatlantike, si një shtet i së drejtës, demokratik dhe garant i lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut, duke e shndërruar sistemin e drejtësisë që të jetë i hapur për këdo, të frymëzojë besim te kushdo dhe të sigurojë drejtësi për këdo”.

Realizimi i vizionit strategjik, pritet të arrihet nëpërmjet zbatimit të objektivave konkretë të përcaktuar në përmbajtje të dokumenteve, të tilla si: zhvillimi dhe konsolidimi i shtetit demokratik bazuar në liritë dhe të drejtat themelore të të gjithë individëve; qeverisje e mirë, luftë ndaj korrupsionit dhe fenomeneve të tjera negative që pengojnë zhvillimin e integritetit dhe vendit dhe garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës; pavarësi, transparencë, përgjegjshmëri dhe efikasitet në funksionimin e sistemit të drejtësisë; zbatimi i ligjit dhe mbarëvajtje e reformës në drejtësi; harmonizim të legjislacionit të sistemit të drejtësisë; bashkëpunim ndër-institucional midis institucioneve të ndryshme të gjyqësorit.

Në procesin e realizimit të angazhimeve të Qeverisë Shqiptare për forcimin e shtetit të së drejtës për të garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e institucioneve, fokusi kryesor për periudhën afatshkurtër, midis të tjerave, do jetë: forcimi i pavarësisë së prokurorëve në procesin e hetimit, si dhe përmirësimi i transparencës dhe i efikasitetit të organeve të drejtësisë.

Problematika e hasur në organin e prokurorisë është e ngjashme me atë të pushtetit gjyqësor, për shkak të ndërlikues së veprimtarisë së këtyre operatorëve. Edhe organi i prokurorisë perceptohet të vuajë nga korrupsioni; nga ndikimet/influencat e të tretëve në veprimtarinë e tij; nga niveli jo i kënaqshëm i procedurave dhe i efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale; dhe nga transparenca e ulët dhe mungesa e besimit të publikut te ky organ.

Lidhur me forcimin e pavarësisë së prokurorëve në procesin e hetimit, ligji për policinë gjyqësore, i cili ka hyrë në fuqi, ka plotësuar kuadrin ligjor mbi forcimin e kapaciteteve investiguese në Polici dhe Prokurori. Rregullat e reja forcojnë autonominë e prokurorisë në hetimin paraprak dhe mundësinë për hetime proaktive, si dhe funksionimin me efikasitet të Këshillit të Prokurorisë. Megjithatë, nevojiten të merren hapa të tjera, kryesisht, lidhur me zbatimin e kuadrin ligjor në mbështetje të risive

ligjore të sjella në forcimin e autonomisë së prokurorisë në hetimin paraprak dhe mundësinë për hetime proaktive¹. Këto masa duhen ndërmarrë tashmë bazuar në dokumentin strategjik të miratuar për sistemin e drejtësisë, si një premisë bazë për suksesin e aktiviteteve të programuara qartë dhe me veprimtari të mirëkoordinuara në nivel ndërinstitucional.

2. Forcimi i luftës kundër korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit mbetet një prej prioriteteve thelbësore të Qeverisë Shqiptare. Për këtë qëllim, mbetet imperative zbatimi i plotë i Strategjisë së Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente, të miratuar me vendimin nr. 1561, datë 3.10.2008 të Këshillit të Ministrave, si dhe i dokumenteve të tjera strategjike të cilat parashikojnë masa plotësuese për luftën kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë. Në funksion të adresimit të suksesshëm të luftës kundër korrupsionit, fokusi kryesor për periudhën afatshkurtër, midis të tjerave, është zbatimi i efektshëm i Strategjisë Antikorrupsion dhe i planit të saj të veprimit, forcimi i masave për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të ndryshme të përfshira në luftën kundër korrupsionit, si dhe mbajtja e statistikave të sakta në vijueshmëri me rezultate të vërtetuara, lidhur me hetimin dhe dënimet e rasteve të korrupsionit në të gjitha nivelet.

Në këtë kuadër, nevojitet marrja e masave të mëposhtme:

i) Rritja e numrit të çështjeve të hetuara për korrupsionin përmes forcimit të kapaciteteve të shërbimeve policore antikorrupsion dhe të aftësive profesionale. Trajnimi i shërbimeve duhet të vazhdojë dhe përdorimi i metodave speciale të hetimit në luftën kundër korrupsionit duhet të zgjerohet;

ii) Shtrirja e hetimeve kundër korrupsionit edhe në nivelet e mesme dhe të larta të administratës publike nëpërmjet rritjes së numrit të hetimeve proaktive në luftën kundër korrupsionit, përdorimit sa më efektiv të teknikave speciale të hetimit për sigurimin e provave dhe goditjen e korrupsionit me qëllim rritjen e numrit të rasteve të hetimit të veprave penale të korrupsionit në nivelet e mesme dhe të larta të administratës.

iii) Forcimi i koordinimit ndërinstitucional për luftën kundër korrupsionit nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis Policisë dhe DPD-së, FIU-së, DPT-së, SHISH-it, SHIU-së etj., duke përfshirë edhe krijimin e një sistemi solid statistikor që pasqyron rrjedhën procedurale të procedimeve në çdo fazë.

iv) Vazhdimi i trajnimit specifik të prokurorëve për të mundësuar njohjen e legjislacionit në fuqi për krimin ekonomik/korrupsionin, nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës.

3. Forcimi i luftës kundër krimit të organizuar

Një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare mbetet lufta kundër krimit të organizuar. Thellimi i mëtejshëm i rezultateve pozitive të deritanishme, në luftën ndaj këtij fenomeni, mbeten një prej angazhimeve kryesore. Për këtë qëllim, fokusi kryesor për periudhën afatshkurtër, midis të tjerave është:

i) Forcimi i koordinimit ndërinstitucional për luftën kundër krimit të organizuar, si dhe me partnerët rajonalë dhe të BE-së;

ii) Përdorimi gjerësisht i metodave dhe teknikave moderne në luftën kundër krimit të organizuar;

iii) Thellimi i mëtejshëm i masave në luftën kundër drogës;

iv) Thellimi i mëtejshëm i masave në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore;

v) Thellimi i mëtejshëm i masave në luftën kundër pastrimit të parave;

vi) Përmirësimi i kuadrit institucional në luftën kundër terrorizmit;

vii) Shfrytëzimi në maksimum i mundësive ligjore për sekuestrimin e aseteve produkt i krimit të organizuar;

viii) Paraqitja e statistikave të plota mbi luftën kundër krimit të organizuar, duke përfshirë edhe krijimin e një sistemi solid statistikor që pasqyron rrjedhën procedurale të procedimeve në çdo fazë.

¹ Rubrika “Kushtet aktuale” të kapitullit I “Aspektet ligjore dhe kushtet aktuale” të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.



Për vitin 2012, duhet të intensifikohet më tej lufta kundër narkotikëve, përmes ashpërsimit të politikës penale. Gjithashtu, duhet të vijojë të forcohet bashkëpunimi me agjencitë e huaja të zbatimit të ligjit.

Po ashtu, për vitin 2012, duhet të intensifikohen mjetet e hetimit të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve zbuluese dhe hetuese të rasteve, të trajnimit të oficerëve të zbatimit të ligjit mbi identifikimin, intervistimin e viktimave, si edhe mbi teknikat speciale të hetimit, si dhe nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit me agjencitë e huaja të zbatimit të ligjit, për një hetim të shpejtë dhe efikas.

Në funksion të rritjes së efikasitetit të zbatimit të legjislacionit për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave, që kulmon me numrin e ndjekjeve penale, prioritet mbeten:

- Zbatimi me rigorozitet i detyrave të planveprimit për Strategjinë Ndërsektoriale kundër Krimit të Organizuar, trafikëve dhe terrorizmit, si dhe dokumentit strategjik kombëtar "Për hetimin e krimit financiar;

- Rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional, duke nënshkruar memorandume bashkëpunimi mes Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Policisë së Shtetit, për shkëmbim më të shpejtë të informacionit, përvojës dhe dërgimit të *feedback-ut* për informacionet e shkëmbyera, në funksion të rritjes së cilësisë së hetimeve dhe rritjes së numrit të çështjeve penale të filluara, hetuara e të dërguara në gjykatë;

- Marrja e masave konkrete për të përmirësuar luftën kundër terrorizmit në reflektim të objektivave të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit, 2011-2015 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, të miratuar me vendimin nr. 675, datë 6.7.2011 të Këshillit të Ministrave;

- Përdorimi efikas i mjeteve ligjore me qëllim rritjen e numrit të sekuestrimeve dhe konfiskimeve të aseteve, produkte të krimit të organizuar, nëpërmjet rritjes së numrit të hetimeve pasurore, përmirësimit të vënies në efikasitet të strukturave ligjzbatuese të përfshira në proces dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale të tyre;

- Përmirësimi i politikës penale ndaj veprave, të tilla si: vrasjet, vjedhjet, trafikut të lëndëve narkotike, ku qëndrimi i prokurorisë duhet të jetë i harmonizuar me vullnetin e legjislatorit dhe të ekzekutivit. Këta të fundit i kanë mëshuar nëpërmjet masave legjislative dhe administrative, rëndësisë publike të lartë që normat penale të këtyre veprave penale kanë, në përputhje edhe me vlerat kushtetuese që mbrojnë, sepse lidhen drejtpërdrejt me të drejtat themelore të njeriut siç janë, e drejta e jetës apo dinjiteti i personit. E drejta e jetës dhe siguria e saj janë të shenjta. Rëndësia për mbrojtjen dhe respektimin e tyre është detyrë e organeve shtetërore, përfshirë edhe organin e prokurorisë, të cilat duhet të marrin masa të përshtatshme për të mbrojtur jetën dhe personin, qofshin ato çështje të sigurisë, apo të shëndetit publik;

- Ashpërsimi i politikës penale në rastet e korrupsionit dhe fshehjes së pasurive, produkte të veprës penale nëpërmjet përmirësimit e zbatimit të kuadrit ligjor sanksionues dhe rritjes së efikasitetit të organit hetimor;

- Rritja e numrit të trajnimeve vazhduese të prokurorëve, me qëllim përmirësimin e profesionalizmit të tyre, në hetimin efikas në kohë dhe cilësi të formave të krimit të organizuar.

4. Respektimi i të drejtave të të dënuarve

Një ndër prioritetet kyçe mbetet respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të individëve dhe në mënyrë të veçantë e grupeve vulnerabël, si personave të ndaluar apo të dënuar dhe në mënyrë të veçantë të miturve, në konflikt me ligjin. Në kuadër të respektimit të plotë të të drejtave të të ndaluarve, nevojitet një mbikëqyrje më e mirë e zbatimit të ligjit në këtë drejtim, si mekanizëm që garanton të drejtat e personave të ndaluar apo të burgosurve. Një vëmendje të veçantë në inspektimet me këtë tematikë duhet të kenë rastet e të miturve, që u ka kaluar afati i qëndrimit në paraburgim. Në funksion të rritjes së efikasitetit të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të ndaluarve dhe të dënuarve, prioritet mbeten:

i) Zbatimi me rigorozitet i detyrave të planveprimit për Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për garantimin e të drejtave themelore të individit, duke garantuar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit, të sigurojnë një trajtim njerëzor në paraburgim dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi riedukimi;

ii) Rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional, për shkëmbim më të shpejtë të informacionit, dhe përcjellja brenda afateve ligjore pranë gjykatës, të dosjeve penale për procedim të mëtejshëm gjyqësor, e në mënyrë të veçantë në rastet e të ndaluarve të mitur, në funksion të rritjes së cilësisë së hetimeve dhe rritjes së numrit të çështjeve penale të filluara, hetuara e të dërguara në gjykatë;

iii) Marrja e masave konkrete për të përmirësuar veprimtarinë e prokurorëve në kryerjen e procedurave hetimore në kohë të shpejtë dhe brenda afateve kohore procedurale të parashikuara në ligj, me qëllim respektimin e afateve të paraburgimit të personave të ndaluar apo të dënuar, duke shmangur situatat e zgjatjes së qëndrimit të tyre, të paarsyeshëm, në ambientet e ndalimit apo të paraburgimit.

III. Adresimet ndërkombëtare në luftën kundër kriminalitetit

Në raportin e progresit të vitit 2011² theksohet se Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe Plani i Veprimit të saj përbën një bazë të rëndësishme për vazhdimin e reformave në të gjitha organet e sistemit gjyqësor, përfshirë edhe organin e ndjekjes penale. Në komentet e përgjithshme të ekspertëve të huaj theksohet se mangësitë në burimet njerëzore dhe në infrastrukturën teknike përbëjnë shqetësim të vazhdueshëm në mbarëvajtjen e punës së agjencive hetimore dhe ligjzbatuese. Njësitë e përbashkëta hetimore, ndonëse vazhdojnë të jenë instrumente të dobishme për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit, kanë burime njerëzore dhe pajisje teknike të pamjaftueshme.

1. Lufta kundër korrupsionit³

Ekspertët ndërkombëtarë në luftën kundër korrupsionit adresojnë si problematika kyçe mungesën e një përjasjeje proaktive në hetim, si dhe mungesën e burimeve dhe pajisjeve, të cilat vazhdojnë të pengojnë seriozisht hetimin efikas. Në këtë problematikë, një ndër faktorët kryesorë është edhe mungesa e një vijmësie (historiku) solid të rezultateve të hetimeve, procedimeve penale dhe dënimeve në të gjitha nivelet. Në çështjet problematike të adresuara nga ekspertët europianë theksohet se prokurori, për çdo ankesë që i paraqitet për rastet korruptive, ka detyrimin për të hetuar. Parimi i ligjshmërisë duhet të prevalojë në kontrast me parimin e oportunitetit⁴. Problematika e kësaj fushe, detajohet në këto elemente kryesore:

i) Është i nevojshëm forcimi i bashkëpunimit dhe i shkëmbimit të informacionit me institucionet e tjera të përfshira në procesin e hetimeve të aseteve dhe pasurive të paluajtshme me qëllim realizimin e hetimeve administrative në mënyrë efikase. Megjithëse bashkëpunimi ndërmjet agjencive, përfshirë trajnimet e përbashkëta, është përmirësuar më tej, shkëmbimi i informacioneve relevante është shpesh i vonuar ose joefikas. Bashkëpunimi mes agjencive të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë nga njëra anë, si dhe gjykatave nga ana tjetër, mbetet i pamjaftueshëm;

ii) Hetimet për rastet e mundshme të korrupsionit pengohen edhe nga mungesa e aksesit në regjistra të ndryshëm (p.sh. regjistri i mjeteve motorike dhe regjistri i tokës) të agjencive hetimore dhe të zbatimit të ligjit, si dhe nga mungesa e një regjistri qendror të llogarive bankare;

iii) Hetimet proaktive, siç janë hetimet sistematike, të fokusuara mbi bazë rrezikun e mundshëm korruptiv për raste dhe fusha të caktuara mungon në Shqipëri;

iv) Pengesë serioze për hetime efikase dhe të suksesshme mbetet imuniteti i plotë i zyrtarëve të lartë. Imuniteti i zyrtarëve të lartë rrallë hiqet dhe mungesa e konfidencialitetit në rastin e heqjes së imunitetit, pengon seriozisht efikasitetin dhe suksesin e hetimeve;

² http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/al_rapport_2011_en.pdf

³ Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore" Progresraporti 2011 për Shqipërinë, Bruksel 12.10.2011

⁴ Expert Report "Rule of Law Mission - the Fight against Corruption", 7 - 11 June 2010, dorëzuar më 20 mars 2012



v) Pak përparim është bërë në krijimin e një vijimësie (historiku) solid të hetimeve proaktive, ndjekjen dhe dënimit në çështjet e korrupsionit të të gjitha niveleve. Veçanërisht të rralla janë hetimet e rasteve të korrupsionit në nivelet e larta.

2. Lufta kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave, trafikimit të qenieve njerëzore dhe lëndëve narkotike⁵

Ekspertët ndërkombëtarë në luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë pastrimin e parave, trafikimin e qenieve njerëzore dhe drogës theksojnë domosdoshmërinë e rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të zbatimit sistematik dhe rigoroz të kuadrit ligjor. Adresimi i problematikës fokusohet në zhvillimin e metodave të hetimit për të kryer hetime komplekse. Problematika e kësaj fushe, detajohet në këto elemente kryesore:

i) Duhet të garantohet zbatimi i kuadrit të ri ligjor mbi konfiskimin e aseteve kriminale dhe bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, në mbështetje të dispozitave të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe ligjit nr. 10 193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”. Në këtë drejtim duhet të forcohen ndjeshëm kapacitetet e agjencive të zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar;

ii) Duhet të rritet më tej bashkëpunimi dhe ndërveprimi mbi bazën e procedurave të përbashkëta standarde të punës ndërmjet policisë dhe prokurorisë, kjo në zbatim të kuadrit të plotë ligjor dhe nënligjor për policinë gjyqësore;

iii) Në luftën kundër pastrimit të parave përpjekje të mëtejshme duhet të bëhen për të adresuar nivelin e ulët të raportimit të transaksioneve të dyshimta nga sektori bankar dhe jobankar, kjo nëpërmjet rritjes së zbatimit të kuadrit ligjor ekzistues dhe përmirësimit të mjeteve dhe ekspertizës së Teknologjisë së Informacionit dhe të agjencive relevante. Cilësia e Raporteve të Transaksioneve të Dyshimta vazhdon të mbetet sfidë;

iv) Nevojitet forcimi i kapaciteteve të autoriteteve të zbatimit të ligjit për hetimin e pastrimit të parave dhe krimit financiar;

v) Kërkohet rritja e përpjekjeve për përmirësimin e teknikave të vlerësimit të riskut, hetimeve proaktive, si dhe ngritja e një historiku solid të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve;

vi) Kërkohet zhvillimi i mëtejshëm i metodave të hetimit për të kryer hetime komplekse;

vii) Kërkohet rritja e ekspertizës dhe autoriteti i hetuesve dhe bashkëpunimi ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit duhet të forcohen;

viii) Lufta kundër trafikimit të drogës, pastrimit të parave, trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtja e viktimave të saj duhet të intensifikohet dhe të kryhet sistematikisht, si dhe kuadri ligjor për konfiskimin e aseteve kriminale duhet të garantohet sistematikisht.

3. Garantimi i të drejtave të njeriut

Në garantimin e të drejtave civile dhe politike të njeriut ekspertët europianë theksojnë nevojën e marrjes së masave për forcimin e hetimeve gjyqësore për rastet e keqtrajtimit të të ndaluarve në rajonet e policisë, në paraburgim dhe në burgje.

IV. Rekomandime

Në kuadër të forcimit të veprimtarisë së organit të ndjekjes penale në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2012, rekomandohen:

1. Forcimi i shtetit të së drejtës për të garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e institucioneve të sistemit të drejtësisë për përmbushjen e detyrimeve të rekomandimit nr. 7 të planit të veprimit për integrimin europian dhe për përmbushjen e detyrimeve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

⁵ Kapitulli 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”, Progresraporti 2011 për Shqipërinë, Bruksel 12.10.2011
4982

Në kuadër të këtij rekomandimi mbetet imperative zbatimi efikas i rregullave të reja për forcimin e pavarësisë së prokurorëve në procesin e hetimit (ligji për policinë gjyqësore) dhe forcimi i kapaciteteve hetimore në Polici dhe Prokurori. Rregullat e reja forcojnë autonominë e prokurorisë në hetimin paraprak dhe japin mundësinë për hetime proaktive. Gjithashtu, nevojitet përmirësimi i efikasitetit të Këshillit të Prokurorisë.

2. Forcimi i luftës kundër korrupsionit lidhur me ndjekjen dhe dënimin e çështjeve të korrupsionit në të gjitha nivelet për përmbushjen e detyrimeve të rekomandimit nr. 8 të planit të veprimit për integrimin evropian dhe për përmbushjen e detyrimeve të Strategjisë Antikorrupsion. Në kuadër të këtij rekomandimi mbeten imperative:

i) Rritja e numrit të çështjeve të hetuara për korrupsionin përmes forcimit të kapaciteteve të shërbimeve policore antikorrupsion dhe të aftësive profesionale. Trajnimi i shërbimeve duhet të vazhdojë dhe përdorimi i metodave speciale të hetimit në luftën kundër korrupsionit duhet të zgjerohet;

ii) Shtrirja e hetimeve kundër korrupsionit edhe në nivelet e mesme dhe të larta të administratës të çdo niveli të qeverisjes, si pushtetit vendor, ashtu edhe pushtetit qendror, publik nëpërmjet rritjes së numrit të hetimeve proaktive në luftën kundër korrupsionit, përdorimit sa më efektiv të teknikave speciale të hetimit për sigurimin e provave dhe goditjen e korrupsionit me qëllim rritjen e numrit të rasteve të hetimit të veprave penale të korrupsionit në nivelet e mesme dhe të larta të administratës;

iii) Forcimi i koordinimit ndërinstucional për luftën kundër korrupsionit nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis Policisë dhe DPD, FIU, DPT, SHISH, SHIU etj.;

iv) Vazhdimi i trajnimit specifik të prokurorëve për të mundësuar njohjen e legjislacionit në fuqi për krimin ekonomik/korrupsionin, nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës.

3. Forcimi i bashkëpunimit të Prokurorisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për procedimin e veprave penale në fushën e doganave dhe ato që lidhen me taksat e tatimet në funksion të unifikimit të praktikave në të gjitha prokuroritë. Ky bashkëpunim të forcohet nëpërmjet shkëmbimit të ndërsjellë të informacionit dhe nëpërmjet përfshirjes së strukturave të Ministrisë së Financave, që me ligj iu është njohur cilësia e policisë gjyqësore.

4. Forcimi i luftës kundër krimit të organizuar duke rritur bashkëpunimin me partnerët rajonalë dhe koordinimin e agjencive të zbatimit të ligjit në këtë fushë për përmbushjen e detyrimeve të Rekomandimit nr. 9 të planit të veprimit për integrimin evropian dhe për përmbushjen e detyrimeve të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar. Në kuadër të këtij rekomandimi mbeten imperative:

i) Forcimi i koordinimit ndërinstucional për luftën kundër krimit të organizuar, si dhe me partnerët rajonalë dhe të BE-së;

ii) Përdorimi gjerësisht i metodave dhe teknikave moderne në luftën kundër krimit të organizuar;

iii) Thellimi i mëtejshëm i masave në luftën kundër drogës;

iv) Thellimi i mëtejshëm i masave në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore;

v) Thellimi i mëtejshëm i masave në luftën kundër pastrimit të parave;

vi) Përmirësimi i kuadrit instucional në luftën kundër terrorizmit;

vii) Shfrytëzimi në maksimum i mundësive ligjore për sekuestrimin e aseteve produkti i krimit të organizuar;

viii) Paraqitja e statistikave të plota mbi luftën kundër krimit të organizuar në funksion të krijimit të një sistemi solid statistikor që pasqyron rrjedhën procedurale të procedimeve në çdo fazë.

5. Përmirësimi i trajtimit të të drejtave të të ndaluarve në rajonet e policisë, në qendrat e paraburgimit dhe në burgje, forcimi i ndjekjes gjyqësore të çështjeve për keqtrajtim, si dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit në këtë drejtim për përmbushjen e detyrimeve të rekomandimit nr. 12 të planit të veprimit për integrimin evropian dhe për përmbushjen e detyrimeve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë. Në kuadër të këtij rekomandimi mbeten imperative:

i) Zbatimi me rigorozitet i detyrave të planveprimit për Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për garantimin e të drejtave themelore të individit, duke garantuar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit të sigurojnë një trajtim njerëzor në paraburgim dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi riedukimi;



ii) Rritja e bashkëpunimit ndërinstucional, për shkëmbim më të shpejtë të informacionit, dhe dosjeve penale, në funksion të rritjes së cilësisë së hetimeve dhe rritjes së numrit të çështjeve penale të filluara, hetuara e të dërguara në gjykatë;

iii) Marrja e masave konkrete për të përmirësuar zbatimin e kuadrit ligjor për respektimin e të drejtave të të dënuarve apo të ndaluarve.

6. Zbatimi rigoroz i rregullave procedurale mbi afatet e hetimit paraprak, si premisë bazë e një procesi të rregullt ligjor të mbrojtur nga nenet 28, 31 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe nga neni 6 i KEDNj-së. Këto rregulla mundësojnë përfundimin e procesit penal brenda një afati të arsyeshëm dhe garantojnë edhe të drejtën efektive të mbrojtjes në një proces penal. Respektimi i këtyre rregullave jo vetëm siguron të drejtën kushtetuese të individëve për një proces të rregullt ligjor, por rrit edhe besimin publik tek efektiviteti i ndjekjes penale. Për këtë qëllim mbetet imperative:

i) Zhvillimi i hetimeve paraprake brenda afateve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Prokuroria duhet t'i kushtojë vëmendje maksimale përpilimit të vendimeve për zgjatjen e hetimeve paraprake, duke shmangur formalizmin dhe duke treguar konkretisht dhe në mënyrë të plotë shkaku e kompleksitetit të çështjeve apo të pamundësisë objektive për përfundimin e veprimeve hetimore brenda afatit të rregullt ligjor;

ii) Gjithashtu, duhet të përmirësohet administrimi i kohës në hetimet paraprake dhe i afateve, duke shmangur intervalet kohore, gjatë të cilave nuk kryhen veprime hetimore. Në këtë drejtim, duhet të disiplinohen procedimet penale, nëpërmjet zbatimit të sanksioneve ligjore në rastet kur subjektet e treta shkelin afatet në përmbushjen e detyrave procedurale (përkthyes apo ekspertë);

iii) Në rastet e referuara nga Policia e Shtetit, të shmangen vonesat në regjistrimin e referimeve dhe në vendimmarrjen për delegimin e veprimeve hetimore nga prokurori te Policia Gjyqësore. Në të njëjtin kontekst, në rastet e referuara nga DPPPP-ja në prokurori të shmangen periudhat kohore pa veprime hetimore, duke shfrytëzuar maksimalisht afatet hetimore dhe duke proceduar me njoftimin e menjëhershëm të strukturave hetimore të krimit financiar;

iv) Aktet procedurale që i ngarkohen për njoftim Policisë Gjyqësore, të përmbajnë të dhëna të plota të gjeneraliteteve dhe të adresave, si dhe të vendosen afate të arsyeshme për kryerjen e veprimeve të tilla nga Policia Gjyqësore;

v) Të shmangen vonesat kohore administrative për dërgimin e akteve të procedimeve penale, me vendim për pezullimin e hetimeve, sepse dëmtojnë vijimin e hetimit të tyre nga Policia Gjyqësore.

7. Respektimi rigoroz i të drejtave themelore të subjekteve të procedimit penal dhe në veçanti, të të ndaluarve dhe të arrestuarve në çdo fazë të procedimit penal: në hetimet paraprake, në gjykim dhe në ekzekutimin e vendimeve penale si pjesë e rëndësishme e procesit të rregullt ligjor. Respektimi i këtyre të drejtave është në harmoni me parashikimet kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën themelore të kujtudo që gjatë procesit penal të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, për të pasur kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet. Respektimi i të drejtave themelore rrit edhe besimin publik, sepse vonesa në hartimin dhe komunikimin e akteve kanë vetëm një përfundim: vonesa përdoret për të harruar në publik ngjarjen e ndodhur. Në këtë rast, drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar. Gjithashtu, prokuroria duhet të zbatojë rregullin kushtetues për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësisë së komunikimit, të cilat kufizohen në mënyrë strikte në raste dhe procedura të parashikuara me ligj. Nga ana tjetër, vëmendje maksimale duhet t'i kushtohet ekzekutimit të vendimeve penale në kohën e duhur për të siguruar efektivitetin e parimit të sundimit të ligjit dhe për respektimin e vlerave themelore universale të njohura në Kushtetutë, si dinjiteti dhe personaliteti njerëzor. Për këtë qëllim mbetet imperative:

i) Kryerja e njoftimit të subjekteve të procedimit penal për zgjatjen e afatit të hetimeve (neni 324/3 i Kodit të Procedurës Penale), për pushimin (neni 329 i Kodit të Procedurës Penale), mosfillimin (neni 291 i Kodit të Procedurës Penale), për ekspertimin (neni 179 i Kodit të Procedurës Penale);

ii) Zbatimi i detyrimeve mbi materialet e përgjimit (nenet 223/3 dhe 224/2 të Kodit të Procedurës Penale);

iii) Evitimi i zvarritjeve administrative të dërgimit të fashikullit në gjykatë;

iv) Veprimi i prokurorit në kohën e duhur për ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë me burgim, ndaj të dënuarve të proceduar me masën e sigurimit “arrest në burg”.

8. Respektimi i detyrimeve ligjore për kryerjen e veprimeve të rregullta e të vijueshme hetimore në ushtrimin e ndjekjes penale. Përdorimi efektiv i të gjitha mjeteve të kërkimit të provës është detyrim me ligj për të grumbulluar e fiksuar çdo element të vlefshëm për rindërtimin e faktit dhe për individualizimin e fajtorit. Rregullat ligjore për veprimet e rregullta dhe të vijueshme hetimore sigurojnë në praktikë thelbin e detyrës kushtetuese të prokurorisë të sanksionuar në nenin 148 të Kushtetutës për ushtrimin e ndjekjes penale, në emër të shtetit për mbrojtjen efektive të interesit publik që eventualisht cenohet nga kriminaliteti. Për këtë qëllim mbetet imperative:

i) Kryerja e veprimeve të duhura hetimore;

ii) Administrimi i mirë i akteve brenda fashikullit;

iii) Respektimi i rregullave formale të kërkimit të provës;

iv) Përdorimi i mirë i formave të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar;

v) Standardizimi formal i praktikave procedurale;

vi) Evitimi i rasteve, kur prokurori urdhëron marrjen e një prove dhe në fakt nuk e merr atë.

9. Respektimi i detyrimit kushtetues dhe ligjor për fillimin e ndjekjes penale nga prokuroria, që është organi i vetëm kushtetues me atributin për të ushtruar ndjekjen penale dhe për të ngritur akuzë në procesin penal. Për këtë qëllim mbetet imperative:

i) Fillimi i ndjekjes penale në çdo rast, kur të dhënat e para ose referimet janë të mjaftueshme për të proceduar me fillimin e ndjekjes penale. Rritje e kujdesit për të gjitha rastet e referimit për veprat penale të parashikuara nga nenet 283 dhe 283/a/2 të Kodit Penal, si dhe për rastet që kërkojnë përdorimin e metodave speciale të hetimit si “blerje e stimuluar” nëpërmjet vendimmarrjes për regjistrimin e procedimit dhe dhënies së autorizimeve për Policinë Gjyqësore për vazhdimin e veprimeve hetimore në terren;

ii) Përfshirja e prokurorit në hetimin paraprak që në fillimet e veta, për ushtrimin e funksionit ligjor për drejtimin e veprimtarisë hetimore, jo vetëm nëpërmjet delegimit formal për kryerjen e disa veprimeve hetimore, por edhe nëpërmjet diskutimit të përbashkët me drejtuesit e policisë së shtetit me qëllim analizën e thelbit të hetimeve (duke ndjekur praktikën e mirë midis prokurorisë për krime të rënda dhe policisë së shtetit). Në këtë kontekst, të analizohet mundësia për nxjerrjen e rregullave normative nga Prokurori i Përgjithshëm;

iii) Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore të nevojshme për detajimin dhe unifikimin e praktikave procedurale;

iv) Shmangia e rasteve kur për një fakt penal nuk ngrihet akuzë dhe një veprim i tillë nuk rikuperohet as nga prokurori më i lartë;

v) Zbatimi efektiv i ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe shmangia e rasteve kur prokurorët nuk kanë filluar procedimin pasuror ndaj personit nën hetim, ndonëse janë prezent kriteret ligjore.

10. Respektimi i detyrimit ligjor për ndjekjen e një politike të drejtë penale dhe në veçanti e politikës së dënimit me drejtimet e mëposhtme:

i) Ashpërsimi i kërkesave mbi llojin dhe masën e dënimit në gjykimet në shkallë të parë, të cilat zhvillohen me procedurë të shkurtuar, për të vendosur një raport të drejtë midis qëllimeve e dënimit penal për risocializimin e të dënuarit dhe për parandalimin e veprave penale nga njëra anë dhe kërkesave për ekonomi gjyqësore dhe shpejtësi në dhënien e drejtësisë nga ana tjetër. Ky rekomandim duhet të mbahet në konsideratë sidomos për disa vepra penale të përhapura dhe me pasoja ndaj sigurisë publike si vrasje, shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, mbajtje pa leje të armëve luftarake, mbajtje dhe përdorim të lëndëve narkotike etj.;

ii) Zbatimi i kriterëve të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale në rastet e masave të sigurimit, për përshtatshmërinë e tyre me shkallën e nevojave të sigurimit, duke individualizuar masat në raport të



drejtë me rëndësinë e faktit penal, me rrezikshmërinë shoqërore të autorit të veprës penale dhe të vetë veprës penale, sidomos në veprat penale me pasoja të rënda. Në këtë kontekst, në rastet e masave të sigurimit të mbahet në konsideratë të veçantë kushtet ligjore të sanksionuara në nenin 228 pika 3 të Kodit të Procedurës Penale në funksion të ndihmesës së veprimtarisë së Policisë Gjyqësore për të ushtruar në kushte normale hetimet e fazës së hetimeve paraprake. Në të njëjtin kontekst, të ashpërsohen kërkesat në llojin masave të sigurimit në rastet kur procedohet për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, me pasojë dëm ekonomik të rëndësishëm;

iii) Rritja e rasteve të ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë nga Prokuroria e Apelit, kur prokuroria e shkallës së parë nuk e ka ushtruar këtë të drejtë. Ky qëndrim ka efekte të drejtpërdrejta në politikën penale në rastet kur lloji dhe masa e dënimit, të kërkuara nga prokuroria e rrethit nuk ka qenë në raport të drejtë me rrethanat konkrete të procedimit penal. Ky veprim i organit të prokurorisë siguron edhe qëllimin e organizimit të prokurorisë si strukturë e centralizuar dhe hierarkike, në funksion të misionit kushtetues për ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit për një politikë penale eficiente;

iv) Rritja e rasteve të rekursve nga prokurori i apelit për të ruajtur një qëndrim uniform me atë të mbajtur prej tij në seancë gjyqësore në apel. Ky qëndrim duhet të rrisë efektivitetin e ankimeve të prokurorit, shmangien e formalizmit të prokurorëve të apelit, mbështetjen e prokurorëve në shkallë të parë dhe të dëshmojë rritjen e profesionalizmit të prokurorëve, si në paraqitjen e ankimeve, ashtu edhe në përfaqësimin në apel;

v) Rritja e rasteve të rekursit ndaj vendimeve për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim sipas nenit 59 të Kodit Penal dhënë nga gjykatat e apelit, kur prokurori ka krijuar bindje të ndryshme në konkluzionet përfundimtare, mbi rrethanat konkrete të kryerjes së veprës penale dhe kriteret e parashikuara nga ligji. Kjo mënyrë e të proceduarit duhet të përputhet me rolin dhe misionin e Prokurorisë për përfaqësimin e shtetit në procesin penal. Ky rekomandim ka vlerë sidomos për një set veprash penale, si shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, të veprave penale mbi lëndët narkotike apo ato të korrupsionit, të cilat shfaqen me tendencë në rritje sipas statistikave zyrtare. Gjithashtu, duhet një aktivizim më i lartë i prokurorëve për të kërkuar më shumë aplikimin e alternativës së parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal “detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik” bashkë me nenin 59 të këtij Kodi. Kjo alternativë duket të ketë efekte edhe në komunitet, si dhe në risocializimin e të dënuarit;

vi) Duhet të përmirësohet cilësia e hetimeve, gjer tek ashpërsimi i politikës së dënimit për veprat penale kundër mjedisit, sidomos te zonat e mbrojtura, parqet kombëtare pyjore, si dhe për rastet e zjarrvënies në pyje e kullota. Për këtë qëllim, duhet intensifikuar shkëmbimi i informacionit midis organit të Prokurorisë dhe shërbimeve të Policisë Pyjore;

vii) Përmirësimin e politikës penale për veprat penale mbi lëndët narkotike dhe psikotrope, kreu VIII, seksioni III, nenet 283-286 të Kodit Penal. Duhet të identifikohen më mirë dhe të diferencohen në praktikë rastet e përdoruesve dhe të autorit të mbajtjes/shitjes së lëndëve narkotike, ka shfaqur tendenca për zbatimin e alternativave të dënimit me burgim për këto vepra penale, si mënyrë për të justifikuar dënimet e dhëna. Mënyra e procedimit nga Prokuroria duhet të jetë në përputhje me qëllimin e ligjvënësit dhe të japë efektet e dëshiruara të dënimit penal, qoftë edhe në drejtim të parandalimit të përgjithshëm. Kjo çështje mbetet problematike për t’u adresuar saktësisht nga prokuroria me qëllim procedimin e autorëve të këtyre veprave penale dhe orientimin e politikës penale drejt parandalimit të këtyre veprave penale;

viii) Edhe për veprat penale të “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” apo “... mbrojtjes në punë”, kreu II, seksioni VI-VIII, nenet 289-290 të Kodit Penal, kërkesat e organit të akuzës për masën e dënimit duhet të orientohet mbi kufijtë minimalë. Përhapja e gjerë e kësaj figure krimi dhe pasojat e saj në dëm të subjekteve të qarkullimit rrugor apo edhe të popullatës në përgjithësi (dëmtime të pasurisë nga aksidentet, si: shtëpi, lokale, parqe etj.) kërkojnë një qëndrim më të ashpër të organit të akuzës para gjykatës. Gjithashtu, duhet të zbatohen kërkesat e ligjit edhe për dënimet plotësuese të parashikuara nga neni 30 i Kodit Penal, në veçanti për përsëritësit, si ndalimi për të drejtuar automjete etj. Për pasojën më

të rëndë të kësaj vepre penale “humbja e jetës së një apo më shumë personave”, nuk duhet të jepet dënim i lehtë. Për më tepër ky dënim me burgim nuk duhet të shoqërohet me pezullim të ekzekutimit të tij. Këto vendime, në rastet kur nuk i përgjigjen bindjes dhe kërkesave të prokurorit, duhet të rekursohen nga prokuroria. Qëndrimi i prokurorisë duhet të jetë në përputhje me rëndësinë, që i ka dhënë ligjvënësi në caktimin e llojeve e të masës së dënimit të kësaj vepre penale, sipas të cilit për paragrafin e parë parashikohet një dënim me gjobë ose me burgim gjer në 10 vjet, ndërsa për paragrafin e dytë parashikohet dënim me burgim jo më pak se 5 vjet;

ix) Politika penale lidhur me veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake duhet të përmirësohet rrënjësisht. Shpesh, kjo vepër penale është pjesë e procedimeve penale me disa akuza ndaj një të pandehuri, si vrasje, plagosje, kanosje, vjedhje, prishje e qetësisë publike, prodhimi dhe shitje e lëndëve narkotike. “Që të kryesh një vrasje, duhet të kesh me vete dhe një armë luftarake”. Po ashtu, që të kryesh një vjedhje me armë duhet të kesh me vete edhe një armë luftarake. Duhet të shmangen rastet me lloje e masa dënimi të lehta, për më tepër rastet kur kjo vepër penale është e shoqëruar me një vepër penale tjetër. Prokuroria duhet të procedojë në raport të drejtë me përhapjen e kësaj vepre penale, me ndikimin që ajo ka në sigurinë publike dhe me mundësitë potenciale për të shkaktuar vepra të tjera penale;

x) Për veprat penale “Kundër jetës dhe personit”, kreu II, seksioni I-III nenet 76-89/a të Kodit Penal, politika penale duhet të orientohet mbi kufijtë minimalë të parashikuar nga ligji. Qëndrimi i Prokurorisë duhet të jetë i harmonizuar me vullnetin e Kuvendit, i cili i ka pozicionuar këto vepra penale nga pikëpamja sistematike në kreun II të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, duke treguar rëndësinë publike të lartë që ato kanë, në përputhje edhe me vlerat kushtetuese që mbrojnë, sepse lidhen drejtpërdrejt me të drejtat themelore të njeriut siç janë e drejta e jetës apo dinjiteti i personit. Gjithashtu, Kuvendi i ka sanksionuar këto vepra penale me marzhe dënimi të diferencuara dukshëm në Kodin Penal, duke vendosur rregulla që dënimi minimal jepet në raste të veçanta kur konkurrojnë një sërë rrethanash të veçanta të rastit në fjalë. Nga ana tjetër, qëndrimi i prokurorisë duhet të jetë në përputhje edhe me vullnetin e Këshillit të Ministrave, i cili sistematikisht i ka kushtuar vëmendje të posaçme këtyre veprave penale, sepse e drejta e jetës dhe siguria e saj janë të shenjta. Krimet që cenojnë jetën dhe shëndetin e personit përbëjnë një kërcënim serioz për shoqërinë dhe lufta kundër këtij krimi është prioritet i vazhdueshëm i Qeverisë në mbrojtje të së drejtës themelore të jetës. Të drejtat e mbrojtura në kapitullin që ndëshkon krimet kundër jetës dhe personit janë ndër vlerat më themelore që mbrohen, jo vetëm nga e drejta kombëtare, por edhe nga aktet ndërkombëtare, si KEDNJ-JA apo Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Rëndësia për mbrojtjen dhe respektimin e tyre është një detyrë e epërme e organeve shtetërore, të cilat duhet të marrin masa të përshtatshme për të mbrojtur jetën dhe personin qofshin ato çështje të sigurisë, të shëndetit publik.

Duhet të shmanget tendenca dhe orientimi i politikës penale drejt kufijve minimalë ligjorë të llojit e masës së dënimit penal, e cila jep mesazhin më negativ, sepse sulmon drejtpërdrejt dhe në mënyrë agresive sigurinë publike të qytetarëve. Kjo lloj politike asgjëson qëllimet e dënimit penal, qoftë në planin e posaçëm për riedukimin e të dënuarit, qoftë edhe në planin e përgjithshëm për parandalimin e këtyre veprave penale. Ky konkluzion mbështetet edhe nga statistikatat, të cilat tregojnë se një set veprash penale që përfshihen në kreun II të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal janë në rritje. Reagimi i institucioneve publike në këto raste duhet të jetë i koordinuar dhe efektiv.

11. Respektimi i detyrimit ligjor për rregullshmërinë e mbajtjes dhe administrimit të statistikave dhe regjistrimit të veprave penale. Rregullat ligjore në këtë drejtim ndikojnë jo vetëm në masën e përpunimit të statistikave, por japin efekt edhe në të drejtat e subjekteve të procedimit penal, sepse determinojnë kohëzgjatjen e afateve ligjore. Ky rekomandim duhet të harmonizohet edhe me pjesë të tjera të rekomandimeve të mësipërme, të cilat kërkojnë krijimin e një sistemi solid të mbajtjes së statistikave, për veprat penale kundër korrupsionit apo krimet të organizuar, i cili do të mundësojë analizimin dhe krijimin e politikave të përshtatshme për adresimin e tyre në të ardhmen.

12. Ngritja e seksioneve në prokurori për hetimin e krimeve kompjuterike dhe trajnimi vazhdueshëm i prokurorëve në këtë drejtim.



VENDIM
Nr. 474, datë 25.7.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1400, DATË 17.10.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN E KURSEVE NË SHISH DHE TRAJTIMIN
E PJESEMARRËSVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 5, 6, 13, 22 e 30 të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1400, datë 17.10.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Nëse në filialet e trajnimit dhe të kualifikimit të institutit nuk garantohet ushqim, kursantët dhe specialistët trajtohen:

- me fjetje dhe kuotë ushqimi ditore, në masën 1 000 (një mijë) lekë/dita, kur distanca kilometrike e vendbanimit nga vendi ku zhvillohet kursi është mbi 50 km;

- me rimbursim të shpenzimeve të udhëtimit, sipas tarifave për distancat kilometrike, të miratuara me aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi, kur distanca kilometrike e vendbanimit nga vendi ku zhvillohet kursi është deri në 50 km.”.

b) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Punonjësit nga institucionet jashtë SHISH-it, si të akademive ose universiteteve etj., të cilët do të angazhohen në procesin e mësimdhënies, të paguhën sipas kriterëve të përcaktuara për punonjësit mësimorë efektivë të universiteteve dhe shkollave të tjera të larta, në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2012, miratuar për Shërbimin Informativ të Shtetit.

3. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 39, datë 18.7.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Fatmir Hoxha,	Anëtar	i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datat 1.3.2012, 21.3.2012 dhe 10.4.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 3 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ermioni Fidhi, Katerina Fidhi, Fdhigalini Fidhi përfaqësuar nga avokat Abas Brati, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Dallëndyshe Hoxha, e përfaqësuar nga avokat Thimjo Kondi, me prokurë të posaçme.

Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2011-1238 (353), datë 5.7.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, përfaqësuesin e kërkuarit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbështetur në vendimin objekt kërkesë dhe në dosjen gjyqësore, rezulton se kërkuarit janë trashëgimtarë ligjorë të Zoto Fidhi. Ky i fundit, së bashku me Spiro Mosko, është njohur pronar dhe i është kthyer pronësia mbi një ndërtesë në qytetin e Gjirokastrës nga vendimi nr. 125, datë 28.5.1994 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Gjyrokastër (këtu e tutje referuar si vendimi 125), si dhe mbi një truall, në po këtë qytet, nga vendimi nr. 125/1, datë 17.3.1995 i po këtij Komisioni (këtu e tutje referuar si vendimi 125/1).

2. Ndërkohë, ndërtesa objekt e vendimit 125 ishte privatizuar nga subjekti i interesuar me vendim të Bordit të Privatizimit Gjyrokastër nr. 5, datë 8.12.1993, finalizuar me kontratën noteriale datë 2.8.1994. Ndërsa truallin nën këtë ndërtesë, truall që është objekt i vendimit nr. 125/1 subjekti i interesuar e ka blerë nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, me anë të kontratës nr. 2000 Rep., datë 8.3.1996.



3. Ndodhur në kushtet kur për objektet e sipërpërmendura ekzistonin akte që krijonin të drejta pronësie në favor të saj dhe të personave të tjerë, subjekti i interesuar i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me objekt “Anulimin e vendimit nr. 125, datë 28.5.1994 dhe 125/1, datë 17.3.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” me palë të paditur trashëgimtarin e Spiro Mosko dhe degën e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit. Kërkuesit, si trashëgimtarë të Zoto Fidhi, nuk rezultojnë të jenë njoftuar për këtë gjykim apo të jenë thirrur të merrnin pjesë në të.

4. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, trashëgimtari i Spiro Mosko ngriti një kundërpadi me objekt “Lirim dhe dorëzim i truallit dhe objektit të blerë nga paditësja”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. 92, datë 9.2.1999, vendosi rrëzimin e kundërpadisë dhe pranimin e pjeshëm të padisë. Kjo gjykatë la në fuqi kontratat e sipërpërmendura të shitblerjes të viteve 1994 dhe 1996, anuloi plotësisht vendimin nr. 125 dhe anuloi vetëm atë pjesë të vendimit nr. 125/1, që i takon sipërfaqes së truallit që është në pronësi të subjektit të interesuar, ndërsa urdhëroi që ish-pronarit kjo pjesë t’i njihet dhe t’i kompensohet. Ky vendim mori formë të prerë pasi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe nga Gjykata e Lartë, të cilat u vunë në lëvizje nga trashëgimtari i Spiro Mosko.

5. Në vitin 2006, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkuesit njihen si trashëgimtarë ligjorë të Zoto Fidhi, i cili ka vdekur në vitin 1954.

6. Me cilësinë e trashëgimtarit, kërkuesit i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me padi me objekt “Kërkimin e trashëgimit, njohjen si trashëgimtar mbi truallin e përfituar nga veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm, kontrata e shitblerjes së truallit me nr. 2000 Rep. dhe nr. 336 Kol. të datës 8 mars 1996 të hartuar nga noterja G. K., duke e liruar dhe dorëzuar atë”. Kjo Gjykatë, me vendimin nr. 2146, datë 5.12.2008 vendosi rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

7. Kundër këtij vendimi kërkuesit ushtruan të drejtën e ankimit përpara Gjykatës së Apelit Gjirokastër, e cila, me vendimin nr. 111, datë 18.3.2009, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 2146, datë 5.12.2008.

8. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër kërkuesit ushtruan të drejtën e rekursit përpara Gjykatës së Lartë, e cila, me vendimin nr. 00-2011-1238 (353) datë 5.7.2011, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 111 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Në mënyrë të përmbledhur, vendimin e saj Gjykata e Lartë e mbështeti në dy arsytetime: së pari, padia e kërkimit të trashëgimit mund të ngrihet vetëm ndaj dikujt që posedon trashëgiminë, sepse “pretendon se është trashëgimtar ligjor ose testamentar i trashëgimlënësit (pra të gëzojë këtë cilësi)” (f. 8 e vendimit). Rrjedhimisht pala e paditur nuk gëzonte legjitimitetin pasiv. Së dyti, edhe pse vendimi i formës së prerë nr. 92, datë 9.2.1999 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, nuk përbën gjë të gjykuar për kërkuesit, pasi ata nuk ishin palë në atë gjykim, gjykatat nuk mund të mbajnë një qëndrim të ndryshëm nga ai i mbajtur në të përderisa është kërkuar e njëjta gjë e mbështetur mbi të njëjtat prova (f. 12 e vendimit objekt kërkese).

II

Pretendimet e palëve parashtruar Gjykatës Kushtetuese

9. ***Kërkuesit*** pretendojnë se vendimi nr. 00-2011-1238 (353), datë 5.7.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (vendimi objekt kërkese) u ka cenuar të drejtën themelore të pronës nëpërmjet zhvillimit të një procesi të parregullt ligjor, duke arsyetuar se:

9.1 ***Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë.*** Gjykata e Lartë duke keqinterpretuar nenin 349 të Kodit Civil nuk i ka njohur legjitimitetin pasiv subjektit të interesuar që ka qenë në pozitën e palës së paditur. Për pasojë, ky vlerësim ka sjellë rrëzimin e rekursit, pa u gjykuar nga Gjykata e Lartë thelbi i pretendimeve.

9.2 ***Është shkelur parimi i kontradiktoritetit.*** Gjykata e Lartë, duke arsyetuar se vendimi i formës së prerë nr. 92, datë 9.2.1999 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër edhe pse nuk përbën gjë të gjykuar i shtrin efektet edhe ndaj kërkuesve që nuk janë as palë, as trashëgimtarë të palëve në atë gjykim dhe as persona që tërheqin të drejta në atë gjykim, ka cenuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur para se të gjykoresh.

9.3 Është cenuar standardi kushtetues, sipas të cilit vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara, logjike dhe jokontradiktore.

10. **Subjekti i interesuar** gjatë gjykimit parashtroi në mënyrë të përmbledhur këto prapësime:

10.1 Nuk është cenuar e drejta e kërkuesve për akses, pasi Gjykata e Lartë ka interpretuar drejt dhe saktë nenet 349-352 të Kodit Civil. Gjykatat nuk kanë legjitimuar kërkuesit për paraqitjen e padisë së kërkimit të trashëgimit, por i kanë legjitimuar ato për pretendimin e konstatimit të pavlefshmërisë së kontratës së privatizimit.

10.2 Nuk është cenuar e drejta për t'u dëgjuar dhe mbrojtur para se të gjykohesh, pasi vetë Gjykata e Lartë e pranon se nuk ndodhet përpara gjësë së gjykuar për shkak të mungesës së elementit subjektiv. Gjykata e Lartë i ka dëgjuar konform të gjitha rregullave procedurale pretendimet e kërkuesve. Gjykata e Lartë i ka administruar të gjitha provat që janë paraqitur nga kërkuesit. Meqenëse Gjykatës së Lartë i shtrohej i njëjti pretendim, me të njëjtin kuadër ligjor, ajo e kishte të pamundur të arrinte në një përfundim juridik të ndryshëm nga ai i arritur në gjykim të mëparshëm.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

1. Mbi pretendimin për cenimin e të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit) për shkak të keqinterpretimit të nenit 349 të Kodit Civil nga Gjykata e Lartë.

11. Në shqyrtimin e këtij pretendimi, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson të nevojshme të përsërisë qëndrimin e saj konstant se, në kuadër të kontrollit që ajo ushtron në zbatim të nenit 131/f të Kushtetutës, çështjet e interpretimit të ligjit hyjnë në juridiksionin kushtetues vetëm nëse dhe për aq sa ky interpretim ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

12. Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka pranuar, në mënyrë të vazhdueshme, se ajo ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 dhe 131, shkronja “f” e Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në përputhje me standardin e mësipërm, Gjykata duhet të vlerësojë interpretimin e nenit 349 të Kodit Civil të bërë nga Gjykata e Lartë vetëm për aq sa ky interpretim cenon të drejtën e aksesit të kërkuesve.

14. Gjykata ka konsoliduar tashmë praktikën e saj në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit). Gjykata ka vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme se neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se “*Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor*” (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 4, datë 23.2.2011).

15. E drejta e aksesit në gjykatë mund t'i nënshtrohet kufizimeve deri në atë masë sa ato të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e



të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 18, datë 8.7.2009*). Megjithatë, e drejta e aksesit nuk konsiderohet e mohuar apo e kufizuar nëse vetë sjellja apo veprimet e subjektit janë në origjinë të mohimit apo kufizimit.

16. Gjykata Kushtetuese vëren, në vijim të standardeve paraqitur më sipër, se Gjykata e Lartë, edhe pse ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkuesit, sipas tyre, nuk ka shqyrtuar disa pretendime të parashtruara në të. Gjykata e Lartë, duke interpretuar nenin 349 të Kodit Civil, vlerësoi se kërkuesit kishin ngritur padinë e papërshtatshme për të kërkuar posedimin e sendit dhe, për pasojë, pretendimet që kishin të bënin me ligjshmërinë e titullit të pronësisë së subjektit të interesuar nuk mund të shqyrtoheshin për mungesë të legjitimitetit pasiv.

17. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është para së gjithash detyrë e organeve që e zbatojnë atë. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim në përputhje të plotë me interpretimin konstant që ajo i bën ndër vite nenit 349 të Kodit Civil. Vendimi objekt kërkese rezulton se është në koherencë me vendimin nr. 19, datë 15.3.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 1743, datë 28.10.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 1267, datë 26.7.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 00-2007-1553 të vendimit (1254), datë 6.11.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 31.5.2011. Në vlerësimin nëse ky interpretim konstant i nenit 349 të Kodit Civil nga Gjykata e Lartë i mohon kërkuesve të drejtën e aksesit, Gjykata Kushtetuese mban parasysh ekzistencën e mjeteve të tjera procedurale në dispozicion të tyre.

18. Në këtë kuadër, Gjykata Kushtetuese vëren se Gjykata e Lartë ka vlerësuar në vendimin objekt kërkese (f. 8 dhe 9) se kërkuesit kishin në dispozicion padinë e rivendikimit të parashikuar nga neni 296 të Kodit Civil. Kjo padi mund të ngrihet nga çdo subjekt që pretendon se është pronar i një sendi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës. Në vijim të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 31.5.2011, kjo padi është e paparashkrueshme dhe për këtë arsye mund të ushtrohet në çdo kohë. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi objekt kërkese nuk cenon të drejtën e aksesit të kërkuesve, pasi në përputhje me qëndrimin e Gjykatës së Lartë, ata mund të ushtrojnë në çdo kohë padinë e rivendikimit të parashikuar nga neni 296 i Kodit Civil për të mbrojtur të drejtat e tyre.

19. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se interpretimi i ligjit i bërë nga Gjykata e Lartë nuk ka cenuar të drejtën e aksesit të kërkuesve. Gjykata vlerëson se mosshqyrtimi i disa pretendimeve të ngritura në rekurs e ka origjinën te vetë sjellja e kërkuesve, të cilët nuk kanë ushtruar padinë e përshtatshme për mbrojtjen e pronësisë së tyre.

20. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi se është cenuar e drejta e aksesit për shkak të keqinterpretimit të nenit 349 të Kodit Civil, është i pabazuar dhe si i tillë nuk mund të pranohet.

2. Mbi pretendimin e cenimit të parimit të kontradiktoritetit.

21. Gjykata, në jurisprudencën e saj, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin civil, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre.

22. Edhe pse parimi i kontradiktoritetit mund të zhvillohet më shumë nga doktrina dhe jurisprudenca në fushën penale, ku ky i fundit është pjesë e të drejtës së mbrojtjes të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës, është përsëri i zbatueshëm në procesin civil, pasi edhe ky proces duhet të garantojë barazi substanciale të palëve.

23. Në këtë aspekt, një rol të veçantë ka luajtur edhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila e ka ngritur parimin e kontradiktoritetit në nivelin e Konventës Europiane të të

Drejtave të Njeriut, duke e konsideruar si një element të domosdoshëm të një gjykimi të drejtë (*shih Vermeulen k. Belgjikës, vendimi i datës 20 shkurt 1996 § 33; Nideröst-Huber k. Zvicrës, vendimi i datës 18 shkurt 1997, § 24*).

24. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese në procesin civil ka tashmë një praktikë të konsoliduar sipas së cilës parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkon që secilës palë në gjykim t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta sipas kushteve, të cilat nuk e vendosin në dizavantazh ndaj kundërshtarit. Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 25.7.2011*).

25. Gjykata, nga shqyrtimi i vendimit objekt kërkesë e vlerëson të drejtë parashtrimin e subjektit të interesuar se ky parim nuk është cenuar nga Gjykata e Lartë, e cila i ka krijuar të gjitha mundësitë kërkesve për të paraqitur pretendime dhe prova apo për të kundërshtuar ato të palës tjetër. Gjykata vëren se pikërisht në respektim të këtij parimi Gjykata e Lartë, në vendimin objekt kërkesë, ka ndryshuar arsyetimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila konsideronte se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nr. 92, datë 9.2.1999 i shtrin efektet ndaj kërkesve. Gjykata e Lartë nuk e konsideron vendimin nr. 92, të sipërpërmendur, sikur përbën gjë të gjykuar, por e konsideron si një provë, vlera e së cilës është përcaktuar nga ajo pasi i është nënshtruar debatit gjyqësor në respektim të parimit të kontradiktoritetit.

26. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi se është cenuar parimi i kontradiktoritetit është i pabazuar.

3. Mbi pretendimin e cenimit të standardit kushtetues sipas të cilit vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

27. Kërkesi pretendon përpara Gjykatës se vendimi objekt kërkesë është jologjik dhe kontradiktor, pasi Gjykata e Lartë edhe pse shprehet se subjekti i interesuar nuk ka legjitimitetin pasiv, nga ana tjetër shprehet se ky subjekt e ka fituar pronësinë në mënyrë të ligjshme.

28. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik. “E drejta është rregull, dhe e drejta e dhënë logjikisht është e drejtë shumë e mirë”, ka thënë Aristoteli. Një arsyetim i saktë i vendimit është një mënyrë e sigurt që gjeneron legjitimitet në sytë e të interesuarve. Ky efekt do të jetë akoma më i madh nëse palët do ta përjetojnë këtë vendim si pasojë normale e një procesi të rregullt, në të gjithë komponentët e tij.

29. Nga ana tjetër, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është sintezë e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to. Vendimi që përmban ose lejon kontradiktën logjike, cenon rëndë dhënien e drejtësisë. Ai nuk mund të jetë i kuptueshëm dhe bindës dhe për pasojë nuk mund të zbatohet në praktikë. Një vendim i plotë dhe i kuptueshëm pasohet logjikisht edhe me vetë forcimin e sistemit gjyqësor. Ai kontribuon në shprehjen dhe thellimin e vlerave shoqërore që transmetohen përmes normave ligjore (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 8.12.2005*).

30. Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se analiza që i bëhet titullit të pronësisë të subjektit të interesuar i shërben vërtetimit të faktit që ky subjekt nuk e ka fituar pronësinë e tij me anë të trashëgimisë, por me anë aktesh ekzistenca dhe ligjshmëria e të cilave rezulton nga provat në dosje dhe veçanërisht nga vendimi i formës së prerë, nr. 92 të vitit 1999, i sipërpërmendur.

31. Ky fakt rezulton nga vendimi objekt kërkesë në të cilin Gjykata e Lartë shprehet (f. 10) se “Në kushtet që kjo lloj padie (padia për kërkimin e trashëgimit) nuk mund të ngrihet ndaj të paditurës



Dallëndyshe Hoxha, pasi ajo nuk e ka fituar pronën që posedon sot as si trashëgimtare ligjore dhe as si trashëgimtare testamentare e trashëgimlënësit, ky koleg vlerëson se nuk mund të kërkohet ndaj të paditurës as lirimi dhe dorëzimi i pronës, aq më tepër që kjo e fundit e ka fituar pronën në mënyrë të ligjshme. Fakti që ana e paditur, pronësinë mbi objektin dhe truallin e ka fituar në mënyrë të ligjshme është vërtetuar jo vetëm nga provat shkresore, të cilat ndodhen në dosje, por dhe nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nr. 92, datë 9.2.1999.”

32. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se kjo analizë është në mbështetje të arsytimeve mbi të cilat është bazuar Gjykata e Lartë në vendimin e saj.

33. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor janë të pabazuara dhe si të tilla nuk mund të pranohen.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo⁶, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi

Anëtarë kundër pjesërisht: Sokol Berberi

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka rrëzuar pretendimet e kërkuesve Ermioni Fidhi, Katerina Fidhi dhe Fdhigalini Fidhi në lidhje me shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.00-2011-1238 (353), datë 5.7.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, për rrëzimin e kërkesës, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me arsyetimin e shumicës për sa i takon pretendimit të kërkuesve për cenimin e të drejtës së aksesit, sikurse jam shprehur dhe më parë (shih mendimin paralel të vendimit nr.26, datë 13.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

2. *Shumica, në thelb, ka çmuar se “... interpretimi i ligjit i bërë nga Gjykata e Lartë nuk ka cenuar të drejtën e aksesit të kërkuesve. Gjykata vlerëson se mosshqyrtimi i disa pretendimeve të ngritura në rekurs e ka origjinën te vetë sjellja e kërkuesve, të cilët nuk kanë ushtruar padinë e përshtatshme për mbrojtjen e pronësisë së tyre”, duke arritur në këtë mënyrë në përfundimin se “pretendimi se është cenuar e drejta e aksesit për shkak të keqinterpretimit të nenit 349 të Kodit Civil, është i pabazuar dhe si i tillë nuk mund të pranohet”*(shih § 19 dhe 20 të vendimit).

3. Bazuar në parimin *jura novit curia*, Gjykata ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim,

⁶ Gjyqtari Vladimir Kristo votoi pro rrëzimit të kërkesës, por me arsyetim paralel.
4994

mendoj se pavarësisht nga formulimi i kërkesës, pretendimet e mësipërme të kërkuësve duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të të drejtës së ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, të parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës.

4. E drejta e aksesit dhe e drejta për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, standarde këto të mbrojtura respektivisht nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës janë dy çështje me natyrë kushtetuese në thelb të ndryshme dhe me dallime të qarta nga njëra-tjetra.

5. Gjykata, sikurse argumenton dhe shumica, në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 42 të Kushtetutës, e drejta për akses në gjykatë të referon tek e drejta që ka çdo individ për t'u drejtuar në një gjykatë, që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen. Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 41, datë 28.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Sipas legjislacionit procedural shqiptar janë vendime përfundimtare, vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore të shkallës së parë, në qoftë se nuk janë ankimuar brenda afatit të ankimit, si dhe vendimet e gjykatës së apelit, të cilat janë të formës së prerë. Ndaj tyre, organet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore kanë detyrimin për t'i venë menjëherë në zbatim.

7. Nisur nga sa më lart, në çështjen objekt gjykimi, kërkuësit kanë pasur akses të plotë në gjykatë në kuptimin kushtetues. Ata jo vetëm kanë realizuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje përfundimtare, përderisa ankimi i tyre jo vetëm është shqyrtuar dhe konsideruar nga gjykata e apelit, por kjo e fundit ka dalë dhe me një vendim përfundimtar, i cili është i formës së prerë. Nga kjo pikëpamje, mendoj se nuk mund të shtrohet për diskutim cenimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila parashikon standardet minimale për mbrojtjen e këtyre të drejtave nga shtetet palë në të.

8. Çështja që u përket kërkuësve jo vetëm është dëgjuar publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, në rastin konkret Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, por vendimi i marrë prej saj është ankimuar nga kërkuësit në Gjykatën e Apelit të Gjirokastrës, e cila ka shqyrtuar çështjen dhe ka marrë një vendim përfundimtar të formës së prerë. Me marrjen e këtij vendimi, kërkuësit kanë realizuar tërësisht të drejtën e aksesit dhe, për rrjedhojë, procesi i zhvilluar ndaj tyre ka qenë plotësisht i rregullt edhe në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

9. Kushtetutëbërësi shqiptar, duke sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës të drejtën e ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, ka parashikuar një standard më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në raport me ato të parashikuara nga neni 6 i KEDNJ-së. Mosrealizimi i kësaj të drejte nga cilido shtetas shqiptar nuk do të thotë aspak se atij i është mohuar e drejta për akses për sa kohë që ndaj tij është zhvilluar një proces gjyqësor dhe është marrë një vendim nga një gjykatë e pavarur e krijuar me ligj dhe, për më tepër, ky vendim ka marrë formë të prerë në apel gjë që e bën atë përfundimtar. Në këto raste mund të pretendohet vetëm për cenim të së drejtës të ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, në rastin konkret, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

10. Duke e shqyrtuar çështjen nga këndvështrimi i mësipërm, jam i mendimit se kërkuësit, pavarësisht se nuk e kanë pretenduar, kanë realizuar plotësisht edhe të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë, e cila jo vetëm ka pranuar rekursin e paraqitur prej tyre, por njëkohësisht e ka shqyrtuar atë në seancë gjyqësore.

11. Nga sa më lart, jam i mendimit se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka cenuar të drejtën e kërkuësve për një proces të rregullt ligjor.

Anëtar
Vladimir Kristo



MENDIM PAKICE

Nuk mund të bashkohem me vendimin e shumicës së Gjykatës Kushtetuese për rrëzimin e kërkesës së kërkuësve Ermioni Fidhi etj., për arsyet si vijon:

1. Nga dosja gjyqësore rezulton se i quajtori Zoto Fidhi bën pjesë në rrethin e subjekteve që përfitonin nga zbatimi i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, si i shpronësuar. Me vendimin nr. 125, datë 28.5.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Gjyrokastër, kërkuësve - trashëgimtarë të Zoto Fidhi, si dhe trashëgimtarëve të Spiro Mosko - u është njohur dhe kthyer pronësia mbi një godinë njëkatëshe në krah të Nënstacionit Elektrik, Gjyrokastër.

Po ky Komision, me vendimin nr. 125/1, datë 17.3.1995, u ka kthyer pronësinë trashëgimtarëve të Zoto Fidhi (kërkuësve) dhe Spiro Mosko, mbi një sipërfaqe të lirë 3091 m², duke u njohur pronësinë njëkohësisht mbi dy sipërfaqe trualli prej 1029 m² dhe 180 m², mbi të cilën ngrihej dhe një godinë njëkatëshe. Rezulton, gjithashtu, se me kontratën e shitblerjes, datë 2.8.1993, subjekti i interesuar (pala e paditur në gjykimet e zakonshme) Dallëndyshe Hoxha ka blerë objektin e quajtur “*Reparti i Leshit dhe i Konfeksioneve*”, ndërsa truallin prej 180.4 m² e ka marrë me qira. Më pas, me kontratën e shitblerjes (privatizimit), datë 8.3.1996, e paditura (subjekti i interesuar) Dallëndyshe Hoxha ka blerë nga dega e AKP-së Gjyrokastër edhe truallin prej 773 m², kthimi i të cilit ka qenë objekti i padisë së paditësve (kërkuësve).

2. Me vendimin nr. 2146, datë 5.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, është rrëzuar padia e paditësve (kërkuësve) me arsyetimin se të paditurës i mungon legjitimitimi pasiv.

Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. 111, datë 18.3.2009, ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të gjykatës së rrethit, por me arsyetim tjetër, dhe konkretisht se çështja e paraqitur për gjykim përbën gjë të gjykuar në kuptim të nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile. Mbi rekursin e paditësve (kërkuësve) Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 353, datë 5.7.2011, ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër, por me arsyetim tjetër, dhe konkretisht se të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv, në kuptim të nenit 349 të Kodit Civil.

3. Kërkuësit (paditësit në gjykimet e zakonshme) i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si jokushtetues të vendimit të mësipërm të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se ky vendim *u cenon atyre të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur*, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

4. Sipas kërkuësve, *cenimi i aksesit* ka ardhur si rezultat i interpretimit të gabuar nga ana e Gjykatës së Lartë të nenit 349 të Kodit Civil, duke arsyetuar në vendimin e kundërshtuar se padia për kërkimin e trashëgimit mund të ngrihet vetëm ndaj personit që pretendon se posedon pasurinë trashëgimore me cilësinë e trashëgimtarit dhe jo ndaj personit që e posedon pasurinë trashëgimore në një mënyrë tjetër.

Shumica e Gjykatës Kushtetuese e ka rrëzuar këtë pretendim të kërkuësve duke arsyetuar, në esencë, se *Gjykata e Lartë nuk i është futur shqyrtimit në themel të rekursit, sepse në interpretim të nenit 349 të Kodit Civil, ka vlerësuar se kërkuësit kishin ngritur padi të papërshtatshme për të kërkuar posedimin e sendit dhe, për pasojë, pretendimet që kishin të bënin me ligjshmërinë e titullit të pronësisë të subjektit të interesuar nuk mund të shqyrtoheshin për mungesë të legjitimitetit pasiv*. Shumica në vendim shton, gjithashtu, se *Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim në përputhje me interpretimin konstant që ajo i bën ndër vite nenit 349 të Kodit Civil, dhe se në vlerësimin nëse ky interpretim konstant i nenit 349 të Kodit Civil nga Gjykata e Lartë i mohon kërkuësve të drejtën e aksesit, Gjykata Kushtetuese mban parasysh ekzistencën e mjeteve të tjera procedurale në dispozicion të tyre, siç është padia e rivendikimit*.

Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë, mendoj se arsyetimi i shumicës është i gabuar. Vetëm fakti se interpretimi i nenit 349 në vendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë është në përputhje me interpretimin e saj konstant për këtë nen, nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar se ky interpretim është i drejtë.

Është e vërtetë se sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, si dhe jurisprudencës së krahasuar, Gjykatës Kushtetuese nuk i kërkohet të shqyrtojë konstatimin e fakteve apo interpretimin e ligjeve të zakonshme të bërë nga gjykatat e zakonshme, me kusht që vendimet e gjykatave të zakonshme të mos kenë shkelur të drejtat kushtetuese. I tillë është rasti kur në një vendim të gjykatës së zakonshme, të drejtat kushtetuese nuk janë respektuar apo janë aplikuar në mënyrë të gabuar, duke përfshirë rastet kur aplikimi i ligjit ka qenë haptazi/dukshëm arbitrar, ... apo kur të drejtat themelore procedurale janë shkelur (të drejtat për gjykim të drejtë/fair, akses në gjykatë, e drejta për mjete efektive, etj.). Një qëndrim të tillë ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese Gjermane. Kështu, kjo gjykatë në çështjen Mefisto, ndër të tjera, është shprehur se në *mënyrë të veçantë*, “konstatimi dhe vlerësimi i fakteve dhe interpretimi dhe aplikimi i ligjeve, në çështjet që u janë paraqitur për shqyrtim, janë detyra të gjykatave të zakonshme dhe nuk mund të rishqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese Federale, dhe se Gjykata Kushtetuese e sheh funksionin e saj në përcaktimin nëse, gjykatat e zakonshme, në fakt, kanë peshuar në mënyrë adekuate të drejtat e palëve në konflikt, në bazë të Ligjit Bazë (Kushtetutës), nëse ato (gjykatat e zakonshme) u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese, që implikohen në çështje, dhe nëse vendimi i gjykatës së zakonshme demonstroi ndonjë konceptim të pasaktë të esencës së të drejtës themelore – objekt shqyrtimi”. Edhe Gjykata Kushtetuese e Bosnjë-Hercegovinës, pothuajse në të njëjtën linjë, është shprehur se Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë interpretimin e ligjeve të bërë nga gjykatat e zakonshme në rastet kur interpretimi dhe aplikimi i ligjit nga ana e tyre ka qenë haptazi i gabuar (*shih vendimin BIH-2002-2-002*).

Për pasojë, Gjykata Kushtetuese, në funksion të shqyrtimit të pretendimit të kërkuesve për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë, duhet të ekzaminonte nëse interpretimi nga Gjykata e Lartë i nenit 349 të Kodit Civil ishte ose jo haptazi i gabuar.

Mendoj se interpretimi i këtij neni nga Gjykata e Lartë, për sa i përket çështjes se ndaj kujt mund të ngrihet padia e kërimit të trashëgimit (legjitimitimi pasiv), është haptazi i gabuar.

Sipas kësaj dispozite, *trashëgimtari mund të kërkojë me padi nga kushdo që posedon ... pasurinë trashëgimore, njohjen e tij si trashëgimtar dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore...*

Në vendimin e kundërshtuar, Gjykata e Lartë është shprehur se “..ajo çka është parashikuar në nenin 349 të Kodit Civil ... [është] një nga paditë me anën e së cilës mund të kërkohet pasuria trashëgimore; përdorimi i termi “nga kushdo që posedon ...” nuk nënkupton çdo lloj personi apo subjekti, por nënkupton mbajtjen e pasurisë trashëgimore nga kushdo i cili pretendon se është trashëgimtar (pra, të gëzojë këtë cilësi) dhe në asnjë rast nuk nënkupton që i padituri të ketë fituar pronësinë mbi këtë pasuri në një mënyrë tjetër jashtë trashëgimisë.”

Sipas rregullave të interpretimit, ligjeve nuk mund t’u jepet tjetër kuptim veç atij që del qartazi nga kuptimi i vetë fjalëve duke marrë parasysh lidhjen e tyre, si dhe nga qëllimi i ligjvënësit (*shih nenin 2, paragrafi i parë i Kodit Civil të vitit 1929*).

Duke respektuar këto rregulla, edhe në rastin e interpretimit të nenit 349 të Kodit Civil, duke parë formulimin e këtij neni, del qartë se trashëgimi mund të kërkohet me padi nga kushdo. Në aspektin gjuhësor termi “kushdo” është një përemër i pakufishëm, i cili sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe ka kuptimin “çdo njeri”, “gjithkush”, “cilido”, “secili”. Kjo do të thotë se ky term përjashton çdo lloj kufizimi në personin ndaj të cilit mund të ngrihet padia që parashikon neni 349 i Kodit Civil. E vetmja cilësi që duhet të ketë personi ndaj të cilit duhet të kërkohet trashëgimi, është ajo e poseduesit, pavarësisht nëse ka ose jo titull, e aq më pak nga lloji i titullit të posedimit. Për pasojë, nuk mund të pranohet arsyetimi i Gjykatës së Lartë, se termi “kushdo” nënkupton vetëm ata që e mbajnë pasurinë si trashëgimtarë, duke përjashtuar mbajtësit me tituj të tjerë, përveç trashëgimisë, apo mbajtës pa ndonjë titull.



Prandaj, mendoj se për caktimin e personit kundër të cilit do të ngrihet padia për kërkimin e trashëgimit, vendimtare është situata faktike e posedimit, pa bërë dallim nëse ky posedim ka ardhur si pasojë e ndonjë titulli apo është edhe pa titull, si dhe pa marrë parasysh llojin e titullit: posedimor, pronësor, apo mbajtës i thjeshtë. Pikërisht, duke qenë se e drejta e trashëgimisë është një e drejtë absolute, sipas nenit 349 të Kodit Civil, trashëgimi mund të kërkohet me padi nga kushdo. Për pasojë, edhe neni 350 i Kodit Civil parashikon se padia e kërkimit të trashëgimit mund të ngrihet edhe kundër një personi që e mban pasurinë trashëgimore në bazë të një dëshmie trashëgimi. Në këtë rast, lidhësja “edhe” më shumë se përfshirëse e rastit të personit që e mban pasurinë trashëgimore në bazë të një dëshmie trashëgimi, nënkupton domosdoshmërinë e përfshirjes edhe të personave të tjerë që e mbajnë pasurinë trashëgimore jo në bazë të një dëshmie trashëgimie. Këtej del edhe qëllimi i ligjvënësit për t’i dhënë një mbrojtje të plotë të drejtës kushtetuese të pronësisë që buron nga trashëgimia, si një e drejtë absolute.

Edhe duke i bërë një vështrim historik Institutit të Kërkimit të Trashëgimit, konstatohet se ky institut ka pësuar ndryshime në raport me rregullimet që ka pasur sipas Dekretit për Trashëgiminë (neni 19) dhe sipas Kodit Civil të vitit 1981 (neni 101). Në të dyja këto rregullime, ky Institut ka pasur rregullim të njëjtë. Konkretisht, sipas nenit 19 të Dekretit për Trashëgiminë dhe nenit 101 të Kodit Civil të vitit 1981 “..trashëgimtari ka të drejtë të ngrejë padi kundër personit që mban pasurinë si trashëgimtar... Padia mund të ngrihet edhe kundër personit që mban pasurinë në bazë të një dëshmie trashëgimie ...”. Në ndryshim, Kodi Civil i vitit 1994 ka parashikuar se “trashëgimtari mund të kërkojë me padi nga kushdo që posedon ... pasurinë trashëgimore...”

Pra, siç shihet nga formulimi i neneve përkatëse të Dekretit për Trashëgiminë dhe Kodit Civil të vitit 1981, në mënyrë të shprehur, kërkimi i trashëgimit ishte kufizuar vetëm ndaj personit që e mbante pasurinë si trashëgimtar. Në ndryshim nga këto dy akte ligjore, Kodi Civil i vitit 1994 e zgjeroi rrethin e personave ndaj të cilëve mund të kërkohej trashëgimi, duke e hequr formulimin kundër personit që e mban pasurinë si trashëgimtar dhe duke e zëvendësuar këtë me formulimin nga kushdo që posedon ... pasurinë trashëgimore...

Në këtë mënyrë, në qoftë se me Dekretin për Trashëgiminë dhe me Kodin Civil të vitit 1981, i padituri në padinë e trashëgimit mund të ishte vetëm personi që e mbante pasurinë si trashëgimtar, me Kodin Civil të vitit 1994, u zgjerua sfera e aksesit në gjykatë për kërkimin e trashëgimit, duke dhënë mundësi për kërkimin e tij jo vetëm ndaj personave që e mbajnë atë si trashëgimtar, por duke parashikuar kërkimin e trashëgimit nga kushdo posedues, pavarësisht se e ka me titull apo pa titull.

Interpretimi i mësipërm i bërë nga Gjykata e Lartë në vendimin e kundërshtuar, do të ishte i saktë vetëm në qoftë se rregullimi juridik i këtij Instituti, me Kodin Civil të vitit 1994, nuk do të kishte ndryshuar. Mirëpo me këtë Kod, ligjvënësi qëllimisht, në harmoni edhe me karakterin absolut të së drejtës së pronësisë private që fitohet me trashëgimi (nenit 41 i Kushtetutës së RSH-së), e zgjeroi rrethin e personave ndaj të cilëve mund të kërkohet trashëgimi, duke siguruar kështu një mbrojtje të plotë të kësaj të drejte kushtetuese.

Konkluzionet e mësipërme mbështeten edhe nga një vështrim krahasues i rregullimit të këtij instituti në kodet homologe, italian dhe francez, nga të cilët është frymëzuar edhe Kodi Civil shqiptar. Kështu, mund të konstatoj se në këto kode, rregullimi i Institutit të Kërkimit të Trashëgimit është pothuajse i ngjashëm me atë të Kodit Civil aktual të RSH-së. Konkretisht, sipas nenit 730-4 të Kodit Civil francez trashëgimtarëve ... u njihet e drejta ndaj personave të tretë që janë mbajtës të pasurisë trashëgimore, të disponojnë lirisht këtë pasuri ... Edhe sipas nenit 533/1 të Kodit Civil italian trashëgimtari mund të kërkojë njohjen e cilësisë së tij si trashëgimtar ndaj kujt do që posedon ... pasurinë trashëgimore në titullin e trashëgimtarit ose pa titull, me qëllim që të arrijë kthimin e kësaj pasurie. Duke komentuar këtë dispozitë të Kodit Civil italian, e cila i korrespondon nenit 349 të Kodit Civil shqiptar, autori italian Francesco Galgano, shprehet se trashëgimtarit ligjor, që ka pranuar trashëgiminë i është njohur kundër poseduesit të të mirave materiale trashëgimore, një padi e veçantë: padia e trashëgimisë. Kjo padi ndryshon nga padia e rivendikimit, sepse nuk bazohet mbi provën e të drejtës së

pronësisë, por mbi atë të cilësisë së trashëgimtarit. Kështu, vetëm një dallim vëren autori italian midis padisë për kërkimin e trashëgimit dhe padisë së rivendikimit. Kjo do thotë se edhe nga pikëpamja e subjekteve ndaj të cilëve mund të ngrihet padia e kërkimit të trashëgimit, kjo nuk ka asnjë dallim nga padia e rivendikimit dhe, për pasojë, edhe kjo padi mund të ngrihet ndaj kujtdo mbajtësi të pasurisë trashëgimore, e jo vetëm ndaj personit që pretendon se e posedon pasurinë trashëgimore me cilësinë e trashëgimtarit.

Pra, edhe nga vështrimi krahasues i Kodit Civil shqiptar të vitit 1994 me Kodin Civil italian dhe atë francez, rezulton se në të tria këto kode, trashëgimi mund të kërkohet nga *kushdo*, e jo vetëm nga ai i cili pretendon se është trashëgimtar.

Mendoj se Gjykata e Lartë ka gabuar, sepse nuk ka vënë re ndryshimin në formulimin e neneve përkatëse të Dekretit për Trashëgiminë dhe Kodit Civil të vitit 1981 me nenin 349 të Kodit Civil të vitit 1994. Duke mos vënë re këtë ndryshim në formulim, Gjykata e Lartë në vendimin e saj të kundërshtuar, lidhur me legjitimin pasiv në padinë e kërkimit të trashëgimit, është mbështetur në jurisprudencën dhe doktrinën juridike që ekzistonte para miratimit të Kodit Civil të vitit 1994. Mirëpo me ndryshimin e formulimit normativ, edhe jurisprudenca, edhe doktrina duhet të pësojë ndryshime sipas rregullit që jurisprudenca dhe doktrina juridike ndjekin ndryshimet normative. Në fakt, siç u tha më sipër, megjithëse neni 349 i Kodit Civil të vitit 1994 lidhur me legjitimimin pasiv, ka ndryshuar, Gjykata e Lartë nuk e vë re këtë dhe në vendimin e saj vazhdon të mbështetet në jurisprudencën dhe doktrinën e para vitit 1994, duke ngushtuar kështu në mënyrë jokushtetuese sferën e subjekteve kundër të cilëve mund të ngrihet padia e kërkimit të trashëgimit.

Për sa më sipër, mendoj se Gjykata e Lartë, duke bërë një interpretim haptazi të gabuar, ka ngushtuar sferën e aksesit në gjykatë të kërkuesve, gjë që u shkel atyre të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës).

5. Lidhur me *cenimin e të drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pala kërkuese arsyeton, se cenimi i kësaj të drejte rezulton nga arsyeja e dytë e dhënë nga vendimi i kundërshtuar. Konkretisht, sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë, padrejtësisht, ka shtrirë efektet detyruese të vendimit të formës së prerë nr. 92, datë 9.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyrokastër, edhe ndaj kërkuesve, të cilët nuk kanë qenë palë në këtë gjykim, si dhe nuk janë as trashëgimtarë dhe as persona që tërheqin të drejta nga palët e këtij vendimi.

Mirëpo, në kushtet kur lidhur me pretendimin e parë shpreha opinionin se Gjykata e Lartë u ka cenuar kërkuesve të drejtën e aksesit në gjykatë, vlerësoj se nuk është nevoja të shqyrtohet pretendimi tjetër për cenimin e të drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, sepse këto të drejta e fundit nuk mund të realizohen pa garantuar të drejtën e aksesit në gjykatë.

Megjithatë, çështjen e shtrirjes së efekteve detyruese të vendimit të formës së prerë nr. 92, datë 9.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyrokastër edhe ndaj kërkuesve, mendoj ta shqyrtoj lidhur me arsyetimin tjetër të Gjykatës së Lartë se në vlerësimin nëse ky interpretim konstant i nenit 349 të Kodit Civil nga Gjykata e Lartë i mohon kërkuesve të drejtën e aksesit, Gjykata Kushtetuese mban parasysh ekzistencën e mjeteve të tjera procedurale në dispozicion të tyre, siç është padia e rivendikimit.

Pra, sipas vendimit të shumicës së Gjykatës Kushtetuese, një nga arsyet pse kërkuesve nuk u është cenuar aksesit në gjykatë nga vendimi i Gjykatës së Lartë, është se kërkuesit kanë në dispozicion të tyre mjete të tjera procedurale, siç është padia e rivendikimit.

Mirëpo megjithëse pranon sa më sipër, shumica nuk i ka kushtuar vëmendje arsyetimit të mëtejshëm të Gjykatës së Lartë. Kështu, kjo gjykatë duke pasur parasysh vendimin nr. 92, datë 9.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyrokastër, shprehet se *"pavarësisht se në kuptimin klasik nuk jemi para gjësë së gjykuar, pasi paditësja nuk ka qenë palë në procesin e parë gjyqësor, nuk mund të injorohet fakti që jemi para të njëjtit objekt padie dhe para të njëjtit shkak ligjor të gjykuar një herë dhe se vendimi gjyqësor i formës së prerë është i detyrueshëm në të gjithë harkun e pjesës së tij dispozitive."*

Kështu, me arsyetimin e mësipërm Gjykata e Lartë përjashton për kërkuesit çdo mundësi për ngritjen e padisë së rivendikimit për të cilën aludon Gjykata Kushtetuese. Kjo, për arsye se Gjykata e Lartë i ka dhënë efekte edhe për kërkuesit vendimit nr. 92, datë 9.2.1999 të Gjykatës së Rrethit



Gjirokastrë. Kjo gjë bën të paefektshme apo paragjykon çdo lloj padie që mund të ngrinin kërkuesit për realizimin e të drejtave të tyre. Për pasojë, shumica në vendimin e saj duhet të shprehej edhe lidhur me këtë arsyetim nëse e pranon ose jo atë dhe nëse një qëndrim i tillë cenon të drejtën e aksesit në gjykatë.

Për sa më sipër, mendoj se nuk mund të pranohet se kërkuesit kanë mjete procedurale të tjera për realizimin e të drejtës së tyre për kërkimin e trashëgimit.

Në këto kushte, mendoj se kërkesa e kërkuesve duhet të pranohet dhe vendimi i Gjykatës së Lartë të shfuqizohej si jokushtetues.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Ploçi, Sokol Berberi⁷

VENDIM
Nr. 40, datë 18.7.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 3.5.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 12 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shkëlqim Meçe

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimeve nr. 169, datë 3.12.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.00-2010-455, datë 12.2.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, 43, 131/f, 132, 134/1/g dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 5/4, 6/1 dhe 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), neni 2 i Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së; neni 77 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Shkëlqim Meçe është arrestuar në flagrancë, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të falsifikimit të monedhave, në bashkëpunim, dhe kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit, në bashkëpunim, të parashikuara respektivisht nga nenet 183/2 dhe 236/2 të Kodit Penal (KP).

⁷ Gjyqtari Sokol Berberi i bashkohet mendimit të gjyqtarëve në pakicë për sa i përket pretendimeve të kërkuesve për cenim të së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur përpara Gjykatës së Lartë.

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat ka paraqitur para kësaj gjykate kërkesë me objekt vlefësimin e ligjshëm të arrestimit të kërkuarit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit.

3. Me vendimin nr. 82, datë 1.11.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të kërkuarit dhe ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit “arrest në burg”.

4. Ndaj këtij vendimi, në datë 11.11.2009, ka paraqitur ankim mbrojtësi i kërkuarit.

5. Me vendimin nr. 169, datën 3.12.2009, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak të paraqitjes së tij jashtë afatit ligjor.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendim nr. 00-2010-455, datë 12.2.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, pasi ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

7. Ndërkohë, për shkak të gjendjes shëndetësore të kërkuarit, *medio tempore*, është kërkuar nga ky i fundit zëvendësimi i masës “arrest në burg” me një masë tjetër më të butë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 22, datë 7.12.2009, ka vendosur zëvendësimin e masës së “arrest në burg” me “arrest në shtëpi”.

8. Në datë 25.1.2010, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat ka paraqitur kërkesë për gjykimin e çështjes me të pandehur kërkuarin dhe shtetasin E. M., të akuzuar vetëm për veprën penale “kundërshtim të punonjësit të Policisë së Rendit”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 236/2 i KP-së.

9. Gjatë gjykimit, kërkuari ka pranuar faktin penal dhe ka kërkuar procedimin me gjykim të shkurtuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendim nr. 88, datë 6.4.2010 ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuarit për veprën penale “kundërshtim të punonjësit të Policisë së Rendit” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 236/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 9 muaj burim. Në aplikim të nenit 406 të KPP-së ka vendosur dënimin e tij, përfundimisht, me 6 muaj burgim dhe shuarjen e masës së sigurisë “arrest në shtëpi”. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datë 17.4.2010.

II

10. **Kërkuari Shkëlqim Meçe**, në datën 2.2.2012, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke parashtruar këto shkaqe:

10.1. Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë i kanë cenuar kërkuarin të drejtën e aksesit dhe atë të ankimit. Arsyetimi i Gjykatës së Apelit Vlorë se ankimi është paraqitur jashtë afatit ligjor është rezultat i kuptimit dhe zbatimit të gabuar të neneve 249 dhe 415/1 të KPP-së. Nga përmbajtja e nenit 249 të KPP-së kuptohet që duke përdorur fjalët “nga njoftimi” ligjvënësi nuk ka pasur qëllim të përfshijë edhe datën në të cilën i është njoftuar vendimi. Ky përfundim përforcohet edhe me interpretimin që i bëhet kësaj dispozite në lidhje me nenin 415/1 të KPP-së.

10.2. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk është i arsyetuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve ligjore të ngritura në rekurs. Edhe pse Gjykata e Lartë, në kuptim të nenit 433 të KPP-së, ka në kompetencë të analizojë dhe vlerësojë përputhjen e shkaqeve të paraqitura në rekurs me kërkesat e ligjit, ajo nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet e lartpërmendura të parashtruara në rekurs nga kërkuari.

III

Vlerësimi i Gjykatës

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuarit

11. Gjykata në jurisprudencën e saj në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit, në kushtet e dhënies së një vendimi të ndërmjetëm si ai i masës së sigurimit personal “arrest në burg”, ka theksuar se në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, individit mund t’i drejtohet asaj për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shterur të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 27, datë 20.6.2007 të Gjykatës*



Kushtetuese). Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 1, datë 19.1.200; nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ka theksuar se neni 131/f i Kushtetutës ka të bëjë me faktin se kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar që do të thotë se individit duhet t'i ketë shterur mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore efektive shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 15, datë 18.4.2007; nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Meqë kërkuesi i ka shteruar mjetet e ankimit për “masën e arrestit në burg” dhe ankohet ndaj një vendimi të Gjykatës së Lartë, karakteri i këtij vendimi të ndërmjetëm që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 30/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

14. Për sa më lart, Gjykata çmon se shqyrtimi i pretendimeve të kërkuesit *ratione materiae* hyn në juridiksionin e Gjykatës.

B. Lidhur me themelin e pretendimeve

15. Gjykata thekson, paraprakisht, se ajo i vlerëson pretendimet e kërkuesit në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, ajo vëren se pretendimet e tij kanë të bëjnë me procesin e zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në lidhje me masën e sigurimit (“arrest në burg” e zëvendësuar me “arrest në shtëpi”), e cila është shuar, pas shqyrtimit të themelit të çështjes, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr.88, datë 6.4.2010.

16. Megjithatë, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit dhe i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë janë rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor, i cili ka cenuar lirinë personale të kërkuesit. Nisur nga rëndësia e veçantë që merr pikërisht kjo e drejtë themelore, si baza e pozicionit të përgjithshëm juridik, dhe nga fakti se dinjiteti njerëzor është në qendër të sistemit të lirive të sanksionuara nga Kushtetuta, me qëllim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe për të parandaluar shkeljen e tyre në të ardhmen, si pasojë e parregullsive në lidhje me procedurat e ankimit të masave të sigurimit, në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata çmon të arsyeshme të shqyrtojë në themel pretendimet e kërkuesit, edhe pse kërkesa është paraqitur prej tij në momentin kur masa e sigurimit (“arrest në shtëpi”) është shuar.

C. Lidhur me pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të së drejtës së ankimit

17. Gjykata konstaton se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë dhe të drejtës së ankimit ka të bëjë në thelb me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të së drejtës procedurale penale (interpretimi i neneve 249 dhe 415/1 të KPP-së) nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

18. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar sipas të cilit interpretimi i ligjit material e procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjithashtu, nga ana tjetër, në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor mbi masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë (*shih vendimin nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa më lart, Gjykata çmon se, në rastin objekt shqyrtimi, interpretimi i neneve 249 dhe 415/1 të KPP-së është i lidhur ngushtë me të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor (të drejtën e aksesit në gjykatë dhe atë të ankimit), prandaj Gjykata, në vijim, vlerëson t'u japë përgjigje pretendimeve të tij për cenimin e këtyre parimeve kushtetuese.

21. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, e drejta për akses në gjykatë të referon tek e drejta që ka çdo individ për t'u drejtuar në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen. Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 41, datë 28.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Ndërsa e drejta e ankimit, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, duhet kuptuar si një mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar në një gjykatë më të lartë vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij (*shih vendimet nr. 14, datë 5.7.2005; nr. 5, datë 6.3.2009; nr. 10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.06.2011; nr. 41, datë 28.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë qëllim, dispozitat procedurale parashikojnë si mjete ankimi apelin, rekursin në Gjykatën e Lartë dhe kërkesën për rishikim (neni 407 i KPP-së), duke parashikuar aspektet formale dhe afatet procedurale për ushtrimin e këtyre mjeteve të ankimit.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj, duke iu referuar dhe asaj të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 17, datë 19.6.2009; nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Mospërcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment, një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej apo prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimet nr. 32, datë 2.12.2005; nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin objekt shqyrtimi, mbrojtësi i kërkuesit, në datë 11.11.2009, ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 82, datë 1.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i cili ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit "arrest në burg". Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 169, datë 3.12.2009, ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak të paraqitjes së tij jashtë afatit ligjor dhjetëditor. Kjo gjykatë arsyeton se "... ndryshe nga sa është parashikuar për ankimet e tjera, ligjvënësi për këtë lloj ankimi ka bërë një përjashtim, pasi në mënyrë taksative në nenin 249/1 të KPP-së, është përcaktuar: "Brenda 10 ditëve nga zbatimi ose njoftimi i vendimit të gjykatës, në bazë të të cilit është marrë ose është refuzuar një masë sigurimi, prokurori, i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim në gjykatën më të lartë". Në referim të kësaj dispozite, që nga kjo datë 1.11.2009, të arrestuarit dhe mbrojtësit të tij, brenda 10 ditëve i ka lindur e drejta për të paraqitur ankimin kundër vendimit të mësipërm, ankim ky që duhej të paraqitej më datën 10.11.2009, por që në fakt është paraqitur në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin në datën 11.11.2009, ... , pra jashtë afatit ligjor 10-ditor".

25. Neni 249/1 i KPP-së, në lidhje me ankimin kundër masave të sigurimit, parashikon se "Brenda 10 ditëve nga zbatimi ose njoftimi i vendimit të gjykatës, në bazë të të cilit është marrë ose është refuzuar një masë sigurimi, prokurori, i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim në gjykatën më të lartë" ndërsa neni 415/1 i KPP-së, dispozitë kjo me natyrë të përgjithshme rreth afateve të ankimit



kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, parashikon se *“Afati për të bërë ankim është dhjetë ditë. Ky afat fillon nga dita e nesërme e shpalljes ose njoftimit të vendimit”*.

26. Gjykata konstaton se në lidhje me afatet e ankimit të masës së sigurimit, vetë Gjykata e Lartë, me vendim nr. 28, datë 28.2.2005, në një çështje të ngjashme me rastin objekt shqyrtimi, duke bërë interpretimin e nenit 249/1 të KPP-së, ka mbajtur qëndrimin se në afatin dhjetëditor brenda të cilit i pandehuri ka të drejtë të paraqesë ankimin, nga përmbajtja e kësaj dispozite, kuptohet që, ligjvënësi, duke përdorur fjalët *“... nga njoftimi”*, nuk ka përfshirë edhe vetë datën në të cilën atij i është njoftuar vendimi i gjykatës. Ky përfundim përforcohet edhe me interpretimin që i bëhet kësaj dispozite në lidhje me përmbajtjen e dispozitës së pikës 1 të nenit 415 të KPP-së, në të cilën, veç parashikimit të afatit dhjetëditor brenda të cilit duhet bërë ankimi, në formë qartësisht të shprehur, është parashikuar që ky afat fillon nga e nesërmeja e shpalljes së njoftimit të vendimit.

27. Nisur nga përmbajtja e dispozitave në shqyrtim (nenet 249/1 dhe 415/1 të KPP-së) dhe nga vetë interpretimi që këtyre dispozitave i është bërë nga Gjykata e Lartë, Gjykata çmon se afatit dhjetëditor brenda të cilit duhet bërë ankimi ndaj vendimeve për masat e sigurimit fillon nga e nesërmeja e shpalljes ose njoftimit të vendimit. Sipas këtij interpretimi, në rastin objekt shqyrtimi, rezulton se kërkuesi ka paraqitur ankimin ndaj masës së sigurimit brenda afateve ligjore.

28. Nga sa më lart, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është rezultat i zbatimit të gabuar të neneve 249 dhe 415/1 të KPP-së, si rrjedhojë e të cilit kërkuesit i është cenuar e drejta e aksesit dhe e drejta e ankimit në këtë gjykatë.

29. Gjykata, gjithashtu, vëren se parregullsitë e Gjykatës së Apelit Vlorë në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor, nuk janë plotësuar apo korrigjuar nga Gjykata e Lartë. Në këtë drejtim, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 21, datë 16.4.2012; nr. 4, datë 28.2.2006 dhe nr. 41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në rastin objekt shqyrtimi, edhe pse kërkuesi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë parashtrroi pretendime që kanë të bëjnë me kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga Gjykata e Lartë lidhur me parregullsitë e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, pretendimet e tij nuk u morën në shqyrtim nga ajo gjykatë, edhe pse në raste analoge ajo ka mbajtur një qëndrim të shprehur lidhur me to. Si rrjedhojë, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë në funksion të rolit të saj, si gjykatë e ligjit, në kontrollin dhe respektimin e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta duhej t'u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Për këto arsye, kërkuesit i është cenuar e drejta e aksesit dhe ankimit edhe në Gjykatën e Lartë.

31. Si përfundim, Gjykata vlerëson se, edhe pse pretendimet e kërkuesit janë të bazuara, meqenëse ato kanë të bëjnë me procedurat e ankimit lidhur me masën e sigurimit, tashmë të shuar si rezultat i shqyrtimit të themelit të çështjes, shfuqizimi i vendimeve objekt kërkese dhe, për pasojë, dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë nuk do të sillte asnjë rezultat në drejtim të garantimit të standardeve të procesit të rregullt ligjor. Për pasojë, Gjykata do të mjaftohet, në vendimin e saj, vetëm në konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit të ankimit ndaj masës së sigurimit të kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit të ankimit ndaj masës së sigurimit të kërkuesit në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si pasojë e mohimit të së drejtës së aksesit dhe të së drejtës së ankimit të tij në këto gjykata.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha.

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 1.8.2012
Doli nga shtypi më 1.8.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë